



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal Kacanik**

**Kuvendi i Komunës**  
**-Kryesuesi i Kuvendit-**

**01Nr. 60/01-14703/26**  
**Kaçanik, 18.06.2026**

### **FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VI(gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2026.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 29.06.2026 (e hënë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Selajdin Troni**

---

Në mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të datës 29.06.2026, do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore (KABK) e komunës së Kaçanikut 2027-2029;
3. Propozim Vendim për Riorganizimin e Gjendjes Civile, përkatësish Shuarjen e Zyrave të vendit;
4. Propozim Vendim për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 941/01-11177/21 të datës 29.04.2021 për lejimin e ndarjes së parcelës Nr. 649-0 ZK Kaçanik PSH Shtëpia e Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-8988/2026  
Kaçanik, 30.04.2026

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V (pestë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2026 (Legjislatura e 8), mbajtur me 29.05.2026 (e premte), në katin e tretë, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendi i Komunës prej 21 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 18 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari Betim Shala. Konstatohet se pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 19 anëtarë. Munguan me arsye 2 anëtarë: Buletin Guri dhe Hafize Sallahi (lista e anëtarëve i bashkëngjitet procesverbalit). Nga Ekzekutivi i komunës morën pjesë: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, 08 drejtor të drejtorive, me përjashtim të drejtorit të DBPZHR. Nga zyrtarët: Zyrtari i IT, Zyrtarja e KK, Asistentja e Kryesuesit të KK.

Mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari i MAPL, Nehat Uka. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu-Zyrtar i lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit - Selajdin Troni:** Së pari i përshëndeti të gjithë të pranishmit, iu dëshiroi mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur me emër, dy anëtarë, Buletin Guri dhe Hafize Sallahi mungojnë me arsye. Kushtet pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e V-të të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2026 të Legjislaturës së 8, data 29.05.2026, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030;
3. Propozim Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor të institucioneve arsimore;
4. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026;
5. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Bob;
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërtimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e komunës së Kaçanikut si dhe Emërtimin e Objekteve komunale;
7. Draft Rregullore për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;
8. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin, por nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

### **Aprovoj**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 8 pikave.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës; Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri. Prezentë 18. Konstatohet se Kuvendi i Komunës

### **APROVOJ**

**Procesverbalin nga mbledhja IV(katërt) e rregullt e KK, e legjislaturës së 8, për vitin 2026, të datës 29.04.2026/ Lënda: 01Nr. 060/01-8988/2026.**

#### **Pyetjet dhe Kërkesat**

**z. Jeton Luma:** Kërkesë për DKRS, për çështjen e fushës sportive në Gllaboçicë, të ndërtuar në nëntor të vitit 2024. Javën e kaluar kryetari se bashku me një pjesë të ekzekutivit ishin pjesë e një turneu të organizuar për mësimdhënësit dhe për punëtorët e komunës së Kaçanikut, besoj se e ka pa nga afër gjendjen e fushës sportive. Sipas dokumenteve zyrtare, kontrata bazë ka vlerën 123,859€ e nënshkruar me 04.07.2024.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkoj të bëni pyetje dhe kërkesa pa i elaboruar të njëjtat, se jeni duke dalë jashtë rregullores, jo për të mirë.

**z. Jeton Luma:** Kur po i ngriti pyetje, po thoni jepni faktet. Unë po e shpjegoj problemin, pastaj po e ngriti kërkesën. Edhe herën e kaluar me keni ndërprerë, ndërkaq ne jemi këtu një herë në muaj me i ngritur çështjet.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nuk po e shfrytëzojmë hapësirën këtu për me i ngritur kërkesat e qytetarëve. Ne i adresojmë pyetjet dhe kërkesat, ndërkaq nuk po kërkojmë me na u përgjigjur në formë gojore. Është ofendim për qytetarët që mos me na krijuar hapësirë me i ngritur këtu kërkesat e tyre. Zërin tonë nuk mundet me ndalë askush. Mbaje rendin kryesues. Unë jam me e votuara dhe zëri i votueseve të mi dua të dëgjohet këtu. Qytetarët nuk lejojnë me ma ndalur zërin këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk e keni fjalën ju Kadrije. Ju çdo herë thoni e keni mirë, ndërkaq ka kërkesa që i keni adresuar në ministri, keni shkruar shumë gjëra të rënda. Edhe unë jam me i votuari. Vazhdoni Jeton.

**z. Jeton Luma:** Unë po dua me fakte me i potencuar çështjet, kjo është metoda ime. Unë i japi shifrat dhe arsyet pse po i përmendi.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Nuk mundeni me iu ikur të drejtave që na takojnë neve këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në mbledhjen e fundit i kemi ndalë mikrofonat kur ju keni qenë të papërgjegjshëm dhe keni folur pa rend.

**z. Jeton Luma:** Unë jam shumë korrekt, ndërkaq edhe herën e kaluar me keni ndërhyrë.

**Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Jeton, mendoj se u keqkuptuat pak. Për pyetje dhe kërkesa keni të drejtë me ngritur, nuk mundemi me ia mohuar askujt. Nëse e kuptuat kryesuesin, e pati fjalën me bërë pyetje me të shkurta, ndërkaq nuk iu ikim përgjegjësive nëse është dëmtuar fusha sportive në Gllloboçicë. Janë mjetet e bartura nëse është prishur, marrim veprime të nevojshme.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Ne e kemi këtë mundësi me ardhur një herë në muaj me i ngritur kërkesa dhe pyetjet e qytetarëve. Nuk mundeni me na e ndaluar zërin këtu, se për atë jemi të thirrur këtu. Nuk mundeni me na i ndaluar hapësirën që na lejon ligji.

**z. Jeton Luma:** Aneks kontrata në vlerë 12, 280€ e nënshkruar me 15 tetor 2024, në total investimi është 136 mijë euro. E theksoj kronologjinë për shkak të parregullsive procedurale. Kontrata është nënshkruar 04 korrik 2024, në afat pune 60 ditë. Fusha është përruruar me 03 nëntor 2024, që i bien edhe 90 ditë tjera shtesë, ndërkaq aneks kontrata është nënshkruar me 15 nëntor, pas përrurimit. Përkundër kësaj gjendja e fushës e keni pa sesi është, ende pa i mbushur 2 vite. Janë dhënë 136 mijë euro, për këtë projekt, ndërkaq po me ndalni fjalën për këto probleme që janë esenciale për fshatin tim. Dyshemeja e fushës është e shkatërruar, për shkak të punimeve jo cilësore dhe materialit jo të përshtatshëm, zhveshtorja nuk është funksionale. Kërkoj të bëhen ndërhyrje, të ndërrohet dyshemeja dhe të bëhet funksionale zhveshtorja. Në Gllloboçicë, po krijohet standard që investimet kapitale të bëhen keq, dhe po bëhen ka disa herë dhe kështu po shpenzohet paraja publike.

**z. Xhelal Ceka:** Unë i kam disa kërkesa, por para se të ngriti të njëjtat, dua të dënoj veprimet për dëmtimin e shkronjave të arta të UÇK-së, të vendosura mbi Gurin e shpume në Kaçanik. E dënojmë këtë veprim dhe kërkojmë nga organet kompetente të merren me këtë çështje që të dalin në pah njerëzit e pandërgjegjshëm, dhe të marrin dënimin e merituar. Unë i kam disa kërkesa duke filluar nga f. Gllloboçicë, Lagja e vjetër apo të Xhamia e Vjetër. Kërkesat tjera po i lë për një mbledhje tjetër, se këtyre po iu ngutet për fushatë, ndërkaq unë deri sot nuk e kam marrë fjalën, nuk e kam penguar askënd. Jetoni e mori fjalën shumë me vend, por ju (LVV) e penguat duke bërë zhurmë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nuk e kam me juve, e kam fjalën për kryesuesin që me mbajtur rend, me iu dhënë hapësirë edhe juve edhe Jetonit, se për atë jemi ardhur këtu. Shumë e mirë ishte pyetja e juaja, bile e bashkë ndjejmë atë, ndërkaq ne jemi që kryesuesi mos me qenë i njëanshëm. Vazhdoni se ne jemi në gjendje me iu dëgjuar.

**z. Xhelal Ceka:** Kryesuesi është duke u munduar me mbajtur rend, ndërkaq ne jemi ata që nuk po mbajmë rend, se po bëjmë zhurmë këtu. Unë në çdo mbledhje i kam dëgjuar pallavrat e juaja, ndërkaq unë sot po e tërheq kërkesat e mia, se po iu ngutet me shkuar në fushatë.

1. Rruga e Gajrës, po dëmtohet nga kamionët që bartin peshë të rëndë, si kompania “Salillari” me kamion me peshë 30-50 tonë, pos që dëmtojnë rrugën, po rrezikojnë udhëtarët që ecin në atë rrugë. Qytetarët e Gajrës dhe Ivajës janë me të rrezikuarit në atë rrugë. Aty duhet të gjendet një rrugë, alternative, kur dihet kur është ndërtuar autostrada, kompania “Bektel Enka” ka shfrytëzuar rrugën alternative, e cila rrugë ka pasqyra në çdo pjesë. Askush nuk po merret matjen e peshës se kamionëve që qarkullojnë në rrugën Gajre-Ivajë. Kombibusët e Gajrës që bartin nxënësit dhe udhëtarët e rastit, mbi 14 herë e kalojnë atë rrugë. Veturat normale që lëvizin në atë rrugë janë të rrezikuar në çdo moment. Kërkoj nga DSHPE të merret me këtë problematikë.

**z. Islam Gashi:** 1. Pyetje për drejtorin e DBPZHR lidhur me përfituesit e koshereve të bletëve, 14.04.2026- publikuar, deri sot nuk është bërë ende shpërndarja. Duke marrë parasysh rëndësinë e kohës për sektorin e bletarisë dhe ndikimin direkt që ka vonesa në zhvillimin e kolonive të bletëve dhe aktivitetet sezonale të bletarëve, kërkoj t' me ofrohet një sqarim pse nuk është bërë shpërndarja e tyre dhe kur do të bëhet? Kërkoj të bëhet sa me parë shpërndarja, që mos ti humbë efekti kësaj mbështetje.

2. Kërkesë e disa banorë të f. Stagovë ka të bëjë me asfaltimin e një rrugice në lagjen Dashi, në rrugën “Ekrem Gudaqi”, janë rreth 300m<sup>2</sup> me 10 shtëpi, rrugë e paasfaltuar. Ajo rrugë për momentin nuk ka emërtim, është pronë private, banorët kanë shprehur vullnetin me bërë pronë publike dhe me bërë asfaltimin e saj.

**znj. Ardita Rrahmani:** Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët e Kaçanikut, kam disa kërkesa me i adresuar:

1.Kërkoj që komuna përmes autoritetit të vet dhe kontrollues, varrezat e qytetit të kenë mirëmbajtje të madhe, sidomos në këtë kohë, ku me rritjen e temperaturave, rritet edhe numri i zvarranikëve, gjë që krijon rrezik për ata që i vizitojnë.

2.Në rrugën “Reshat Shehu” para 3 viteve janë vendosur gypat e ri të ujit, ndërkaq nuk është bërë ende kyçja. Banorët kanë konfuzion se kush e bënë kyçje. Sipas tyre kompania e ujësjellësit” Bifurkacioni” nuk mundet me bërë kyçje pa leje. Për çfarë leje bëhet fjalë?

3.A parashihet ndonjë zgjidhje për çështjen e parkingut të automjeteve, sidomos në kohën e pikut të verës, ku vijnë edhe mërgimtarët?

**z. Kjani Zeneli:** 1. E kam një shqetësim qytetar, po ndërlidhem edhe me shqetësimin e z. Xhelal Ceka për dëmtimin e shkronjave të arta të UÇK. Me erdhi mirë prej tij që shprehi keqardhje për këtë gjest. Edhe në e dënojmë këtë akt dhe është për keqardhje ky gjest që e kanë bërë njerëzit shpirtkeq.

2. Shprehi një shqetësim qytetarë e njëjtë gati me shqetësimin e Xhelalit, por pak me ndryshe, e kam petitionit e lagjes Gajre -Ivajë dhe Çaka në rrugën për Gajre. Rruga për Gajre e dimë kapacitetin për sa tonë ngarkesë që kalojnë në atë rrugë. Aty nuk bëhet fjalë vetëm për kompania “Salillari” por edhe për kompaninë “Joni Beton”, gjë që nuk jam kundër tyre, se aty ka shumë punëtorë që mbajnë familje, por ngarkesat me tonë janë shumë të mëdha dhe ajo rrugë ka shumë probleme. Ky shqetësim me ka ardhur mua, ndërkaq kërkesa për petition sa e di unë është adresuar komunës përmes formës zyrtare me protokoll. Ata me janë drejtuar edhe mua se unë jetoj në atë pjesë dhe e njoh mirë atë rrugë. Aty ka mundësi me u bërë një rrugë alternative, është një rrugë që e ka shfrytëzuar “Bektel Enka” për nevoja të veta, është çështja vetëm me u bërë një shkëputje, jo me kaluar tonat se ka shumë rrezik aty, me u shtruar fillimisht me zhavorr pastaj me asfalt, kështu që nuk pengohen e rrezikohen as qytetarët, edhe kompanitë punojnë si duhet. Kjo është mundësi shumë e mirë. Kësaj ia bashkëngjisë edhe rehabilitimin e rrugës për Gajre, se është e dëmtuar shumë në fillim në hyrje.

**znj. Lejla Luta:** Kam kërkesë lidhur me sigurinë e komunikacionit në dy rrugë të qytetit tonë. Bëhet fjalë për rrugët ku qarkullimi i automjeteve është i madh dhe shpesh herë nuk respektohen rregullat për shpejtësinë e lejuar, gjë që paraqet rrezik për banorët dhe për këmbësorët. Kërkoj të shqyrtohet mundësia e vendosjes së pengesat për ngadalësimin e shpejtësisë në rrugën “Hamëz Jashari” dhe në rrugën “Agim Bajrami” – pjesa afër gjimnazit.

**z. Enis Vishi:** E kam një kërkesë, e që besoj se është e pakuptimtë të diskutohet ende në vitin 2026, është fjala për probleme esenciale të jetesës. Banorët e lagjes Gjini ende nuk kanë kanalizim, ndërkaq kanë probleme edhe me mungesën e ujit të pijes gjatë pjesës së madhe të muajve të vitit, e mos flasim për gjëra normale, siç është ndriçimi publik. Është

shqetësuese që banorët e kësaj lagje edhe në këtë kohë jetojnë në kushte të tilla, kështu kërkoj komuna të merr veprime të nevojshme për zgjidhjen e këtyre problemeve sa me shpejt që është e mundur.

**znj. Elona Gjini:** Deshi me replikuar për kërkesën e Enis Vishi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk lejoj me u replika kërkesat.

**z. Heset Malsiu:** Shprehi shqetësimet e mia që në rrugën “Avdullah Baftiu”, shënjizimi i rrugës është prishur edhe në rrugën e magjistrales për Tetovë, edhe nga fshati Dubravë që shkohet në këtë rrugë. Kërkesa ime është që kjo rrugë të shtrohet dhe të lidhet me magjistralen Tetovë- Kaçanik. Ky projekt ka qenë në plan, ndërkaq është mirë dikush me shpjeguar arsyen pse është tërhequr nga prioriteti.

**z. Jeton Luma:** Po e përcjellë një shqetësim të banorëve të fshatit tim për mbylljen e Zyrës së gjendjes civile në Gllloboçicë. Po dua me ditur arsyen, pse është marrë vendimi për mbylljen e kësaj zyre? Kush e ka marrë vendimin, komuna apo është urdhër nga niveli qendror-MPB? Pse nuk ka një njoftim zyrtar për mbylljen e kësaj zyre të vendit.

**znj. Ardita Rrahmani:** Është mirë që qytetarët po na përcjellin live, dhe në kohë reale po i parashtrajnë kërkesat e tyre. Tani sa ka arritur një kërkesë. Në bazë Udhëzimit administrativ të nxjerrë tani së fundi dhe ndryshim plotësimin e tij, për kujdesin parësor shëndetësor, i miratuar tani nga ministria e Shëndetësisë. Kërkesa është, a do të punësohen psikolog, logoped dhe fizioterapeutë në kuadër të QKMF në Kaçanik?

**z. Kjani Zeneli:** E shprehi një shqetësim të f. Bob, pse dritat nuk janë duke funksionuar.

**z. Heset Malsiu:** Për dy kërkesa që i kam ngritur DUKMM, përgjigjet që me janë kthyer nga kjo drejtori, nuk janë në nivelin që unë e vlerësoj të nivelit intelektual të tij. Nuk kam dashur me ia thënë në seancë, ia kam thënë edhe në formë private. Kërkoj për hera tjera përgjigjet të kthehen në nivelin e intelektuale të drejtorit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje e kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

**2. Propozim Vendim për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030;**

E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** Drafti është mjaft voluminoz, është dokument i mirë, shpresojmë të realizohet, ndërkaq në të njëjtën kohë ne sot kemi edhe një pikë në rend pune në kuadër të transportit. Të transporti unë shoh ceket që shërbimi aktual i autobusëve ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme në aspektin e cilësisë, besueshmërisë, frekuencës së linjave dhe komoditetit të përdoruesit. Këtu ceket se transporti jo motorik sidomos përdorimi i biçikletave është shumë i kufizuar, nuk ekzistojnë shtigje të dedikuara apo parkingje të organizuara për biçikleta, duke bërë këtë mënyrë të mangët dhe të pa përshtatshëm për qytetarët që vozisin motoçikletë dhe biçikletë. A është përfshirë në kuadër të pikës tjetër të transportit që e kemi në rend pune, se kjo çështje i prekë shumicën e qytetarëve.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Sot para juve po prezantojmë Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030, ku përmes saj janë përcaktuar prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal të komunës tonë, në përputhje me nevojat

dhe potencialin zhvillimor të Kaçanikut. Kjo strategji është ndërtuar mbi 5 qëllime kryesore bazike. Prioritete e saj janë: nxitja e zhvillimit ekonomik lokal, përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban, zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit, fuqizimi i komunitetit përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale, fuqizimi i qeverisjes lokale dhe rritja e efikasitetit administrativ. Besoj përmes kësaj strategjie do t'i realizojmë projektet zhvillimore të komunës. Të çështja e transportit, të DSHPE janë potencuar dobësitë.

**z. Arian Teneqja:** Pika e transporti është me vonë, por po e ndërlidhem me te. Rregullorja e cakton rregullimin e transportit rrugor, kryesisht rregullimin e shërbimeve, procesin e licencimit e operatorëve që shërbejnë, jo infrastrukturën, se infrastruktura përfshihet në strategji dhe në PZHK. Të shtigjet e çiklizmit, ne si komunë kemi marrë disa hapa në të kaluarën, si shtegu i çiklizmit në Strazhë dhe shtegu i çiklizmit në rrugën “Ahmet Kaçiku” diku 3 km. Në vende dhe rrugë tjera besoj se në të ardhmen do të përfshihen, por rregullorja i përfshinë shërbimet, jo ndryshimet infrastrukturore dhe procesin e licencimit të operatorëve të linjave.

**z. Islam Gashi:** Ky draft raport na tregon pozitën e përshtatshme që ka komuna e Kaçanikut, në mes dy kryeqyteteve, Shkupit dhe Prishtinës. Gjithashtu ka edhe objekte të trashëgimisë kulturore: Kalaja e qytetit, Guri i shpum dhe vendin turistik -Strazha. Ky draft raport na tregon se deri tani komuna e Kaçanikut nuk i ka shfrytëzuar, shpresoj që tani e tutje komuna do të bëjë diçka së paku në sektorin e turizmit për shkak të pozitës që ka, të merr veprime të nevojshme që t'ia kthej shumë vizitorë komunës së Kaçanikut.

**z. Hestet Malsiu:** Po e bëjë një përmbledhje të analizës. Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030 ka strukturë të pranueshme, përmban volum të konsiderueshëm të dhënave statistikore, përshkrime territoriale, por në aspekt profesional dhe strategjik mbetet jo i plotë, jo i mjaftueshëm sa duhet, për tu konsoliduar si dokument afatgjatë i zhvillimit ekonomik lokal. Problemi kryesor është se në shumicën e rasteve, përmbajtja mbetet përshkruese dhe deklarative. Mungon analiza reale strategjike dhe lidhja logjike nëpërmjet problemeve të identifikuar, projekteve zhvillimore, objektivat, financimit dhe implementimit. Një nga shembujt me të qartë është shtrirja demografike 17% në vitet 2011-2024 e paraqitur në kapitullin e popullsisë. Kjo është një nga sfidat funksionale zhvillimore në komunë, sepse lidhet direkt me tregun e punës, ekonominë lokale, migrimin dhe tkurrjen e potencialit zhvillimor. Megjithatë, dokumenti nuk e trajton këtë si problem strategjik qendror dhe nuk formulon politika konkrete për akumulimin e ujit apo krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë. Në mënyrë të ngjashme, dokumenti përshkruan shumë detaje, pozitën gjeografike, gryken e Kaçanikut, resurset natyrore, klimën dhe pasuritë ujore, por nuk i shndërron këto në analiza konkrete ekonomike dhe prioritete zhvillimore. P.sh. nuk ekziston analizë reale për turizmin malor, nuk ka analizë të ekonomisë pyjore, nuk ka analizë për potencialin logjistik apo ndërkuftar, nuk analizë për investime të mundshme në ekonomi të gjelbër. Dokumenti identifikon potencialin territorial, por nuk ndërton model ekonomik mbi të. Problem tjetër është prioritizimi. Strategjia mbulon pothuajse të gjitha fushat, ekonomi, infrastrukturë, bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë administratë, por pa u përcaktuar qartë se cilët sektorë janë prioritet, ku do të fokusohen investimet, cilët sektor do të jenë motor të zhvillimit ekonomik. Kjo e bënë strategjinë me tepër si dokument të përgjithshëm të komunës, sesa strategji të fokusuar për zhvillim ekonomik komunal. Dobësi të mëdha janë mungesa e objektivave të matshme. Strategjia flet për zhvillim ekonomik, përmirësim të infrastrukturës, mbështetje të bizneseve, zhvillimin e turizmit, por nuk përcakton pothuajse askund, sa vende të punës do të hapen, sa investime priten, sa biznese të reja do të hapen, cilat do të jenë rezultatet konkrete deri në vitin 2030. Kjo e bënë shumë me

të vështirë monitorimin për sukseset e dokumentit të strategjisë. Në aspekt metodologjik, dokumenti pretendon se janë bërë analiza të thelluara të konkureshmerisë, por në përmbajtje mungojnë analizat reale, nuk ka analizë të tregut, të zingjirit të vlerës, investive, konkureshmerisë territoriale apo analizë të resurseve. Po ashtu mungon tranzicioni model i planifikimit zhvillimor, mungon tranzicioni i gjelbër, ekonomia qarkore, agjenda e gjelbër, rezidenca klimatike, siguria energjetike dhe adaptimi i ndryshimeve klimatike. Kjo është veçanërisht problematike, se dokumenti është 2026-20230 dhe duhet të jetë i harmonizuar me prioritetet aktuale të BE, ku edhe ne duhet të integrohemi. Në aspektin institucional dhe financiar, dokumenti nuk arrin të dëshmojë realizimin real të strategjisë. Nuk ka analizë të mjaftueshme të kapaciteteve komunale, mekanizmave të qartë të monitorimit, sistem indikator smart dhe plan të qartë financiar për implementimin e strategjisë. Për me tepër, strategjia është 2026-2030, ndërsa analizat financiare janë 2026-2028, duke krijuar boshllëk financiar për pjesën e fundit strategjike. Prandaj, në vlerësimin profesional, dokumenti nuk do të duhej të miratohej në formën aktuale, pa rishikim dhe plotësime substanciale. Strategjia ka rol informues dhe administrativ, por jo si dokument i konsoliduar strategjik për orientimin afatgjatë të zhvillimit të komunës. Para miratimit është e domosdoshme të forcohet analiza ekonomike sektoriale, të qartësohen prioritetet zhvillimore, të vendosen objektiva të matshme, të krijohet sistem real i monitorimit, të përfshihet dimensionimi i tranzicionit të gjelbër dhe klimës, dhe të ndërtohet plan realist financiar dhe institucional për implementim.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Strategjia z. Malsiu i është nënshtruar dëgjimit publik, keni marrë pjesë dhe të gjitha sugjerimet janë inkorporuar këtu. Janë specifikuar prioritet këtu. Vlerat kyçe të komunës se Kaçanikut përfaqësojnë parimet themelore që udhëheqin zhvillimin e qeverisjes lokale. Zhvillimi ekonomik dhe inovacioni janë ndër prioritetet kryesore, duke përkrahur bujqësinë, industrinë dhe turizmin si motor të progresit. Në qendër të vizionit institucional është, qëndrueshmëria mjedisore, përmes ruajtjes së pasurive natyrore dhe orientimi drejt zhvillimit ekologjik afatgjatë, transparencë dhe integritet institucional duke ofruar një administratë të ndershme, të hapur dhe llogaridhënëse që plotëson besimin e qytetarëve. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve është thelbësore për ndërtimin e një demokracie lokale funksionale. Arsimi cilësor dhe fuqizimi i komunitetit, përbëjnë një tjetër vlerë, duke investuar në informimin e gjeneratës së re dhe përfshirjen e saj në zhvillimin kulturor, sportiv dhe shoqëror. Në fund, mirëqenia sociale, barazia, shprehin angazhimin e komunës me garantuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi të jetës së dinjitetshme të parimeve.

**z. Heset Malsiu:** Të parime, si përshkrim është jashtëzakonisht i mirë, por nuk kemi indikator matës, nuk janë paraqitur askund arsyet e shuarjes së bizneseve, sa mendohen me u krijuar në të ardhmen, sa vende pune deri në vitin 2030 do të bëhen për të rinjtë. Të migrimi, cilat janë arsyet që migrojnë njerëzit, a e keni këtë analizë? Pa u bërë analiza të problemit pse ka ndodhur dhe kur doni me arritur, nuk është strategji. Ne mundemi me shkruar çka të duash, por për me krijuar një strategji komunale kaq afatgjatë, bile në fillim është bërë gabim kur është quajtur se strategjia është 4 vjeçare, ndërkaq strategjia është 5 vjeçare.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Strategjia është 2026-2023.

**z. Heset Malsiu:** Strategjia 2026-2023, bëjë 5 vite, jo 4 vite.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Urdhëroni drejtoreshë nëse keni sqarime të nevojshme.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Nuk kam sqarime tjera.

**z. Islam Gashi:** Në bazë të draft strategjisë, të lehtësirat e procedurave për themelimin dhe zhvillimin e bizneseve, shihet si objektivë specifike, shkurtimi i themelimit të kohës së biznesit, vetëm 2-3 orë. Si keni me arritur këtë, se kjo nuk varet vetëm nga komuna. Realisht regjistrimi i biznesit mundet me u bërë online, e kontrollon komuna, pastaj është Zyra e ARBK në Prishtinë e kontrollon se a është në rregull. Për këtë arsye, unë mendoj që kjo objektivë nuk mundet me u arritur për 2-3 orë.

**znj. Arlinda Rakoci Raka:** Është zyrtari të qendra për regjistrimin e bizneseve, që ka kontakte të drejtpërdrejta me ARBK, në çdo ditë, në çdo orë i kryen shërbimet pa problem.

**z. Islam Gashi:** Zyrtari kryesor që është në ARBK në Prishtinë, e kontrollon krejt Kosovën. Munden me qenë fjala vjen 100 biznese. Nga përvoja e di se momentalisht 10-12 ju shkon kohë për regjistrim të bizneseve. E keni theksuar si objektivë strategjike çështjen e regjistrimit të bizneseve, në rregull, por unë mendoj se për 2-3 orë veç me skanuar dokumente me ia caktuar të dhënat e biznesit, nuk munden me u kryer. Nëse keni pasur vetëm sa me mbushur faqen ajo është tjetër, ndërkaq nuk mundet me u realizuar për 2-3 orë. Nëse jemi këtu në vitin 2030, kemi me pa se kjo objektivë qysh është përcaktuar, nuk ka me mundur me u realizuar.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 11 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 8 (5 nga LVV dhe 3 nga VHZK). Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

**Për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Kaçanikut 2026-2030/ Lënda: 01Nr. 104/02-11476/26.**

3. Propozim Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore;

**Kryesuesi i Kuvendi:** Fjalën e ka drejtori i drejtorisë së Arsimit, Gazmend Bunjaku

**z. Gazmend Bunjaku:** Propozim Vendimi është i bazuar në Ligjin për arsimin parauniversitar. Besoj se anëtarët e KK janë të njoftuar që Gjykata supreme e ka shfuqizuar nenin 21 të ligjit, i cili nen ka përcaktuar pak me ndryshe formimin e komisionit për drejtor, zëvendës drejtor dhe stafit përcjellës dhe ne jemi bazuar në nenin 20 sipas Udhëzimit të gjykatës supreme dhe aktvendimit të saj. Nëse ka pyetje, përgjigjem, besoj se nuk ka nevojë me elaboruar me tepër.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Pyetje për drejtorin, cili është ndryshimi, a është të pika 1.4 , ku janë shënuar 2 përfaqësues të këshillit drejtues në cilësi të vëzhguesve në këtë komision?

**z. Gazmend Bunjaku:** Ky është ndryshimi, me nenin që është aktiv tani, duhet të jenë edhe 2 vëzhgues nga këshilli drejtues i shkollës të cilët i përzgjedhë ministria. Roli i tyre është mbikëqyrës- vëzhgues, nuk kanë të drejtë vendimmarrje. Tani komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 3 anëtarë janë ekzekutiv, ndërkaq 2 anëtarë janë vëzhgues, që përzgjidhen nga këshilli drejtues i shkollës.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Unë edhe në KPF e kam cekur se për fat të keq ne në komunën e Kaçanikut operojmë dhe menaxhojmë çdo herë me drejtorë politik të shkollave. Nuk ka shkollë që drejtori nuk është politik dhe i pushtetit aktual. Po me vjen mirë që ministria paska bërë një ndryshim, ku në komision janë 2 vëzhgues, por përderisa nuk janë vendimmarrës këta 2 anëtarë, mendoj se tradita e emërimit të drejtorëve politik do të vazhdoj përsëri. Ne si LVV konfirmoj se do të votojmë kundër.

**z. Jeton Luma:** Meqë jemi duke folur për përgjegjësit e institucioneve tona arsimore, kjo realisht e bartë një përgjegjësi të madhe për të ardhmen për gjenerata që vijnë pas. Drejtorët e shkollave mendoj se nuk duhet të zgjidhen në bazë të preferencave politike, por duhet të zgjidhen ekskluzivisht mbi bazën e meritokracisë, për të sjellë në krye të shkollave njerëz me profesionist, me të përgatitur dhe me të mirë. Një fenomen që e dini edhe ju, njëri nga shkaktarët është politizimi i arsimit, ashtu siç e përmendi edhe kolegja paraprake. Për keqardhje, unë shpesh shoh drejtor të shkollave që janë pjesë e tubimeve. Unë i kuptoj preferencat e tyre politike, por se paku iu thoni që mos të dalin në rrjete sociale. Besoj se pajtoheni plotësisht drejtor me këtë që po e themi, mandej edhe profesor të caktuar, pa dashur me i përgjithësuar, se ka drejtor dhe arsimtarë që janë të mrekullueshëm në punën e tyre. Ky fenomen nuk duhet të merr përmasa, kështu që duhet një tërheqje e vërejtjes se tyre, se po ia humb kredibiliteti institucionit me të rëndësishëm në komunë.

**z. Gazmend Bunjaku:** Kjo që po e thoni Jeton, mendoj se nuk është plotësisht e vërtetë, ka 2-3 drejtor që kanë qenë përkrahës të vizionit, por vazhdojnë me qenë drejtor dhe me bërë punën e drejtorit në formën me të mirë të mundshme. Tjera, ligji nuk i penalizon për me marrë pjesë në tubime. Çka kisha dashur prej juve, por nuk e dëgjova, është dashur me ardhur me një urim, për një nxënëse të shkollës tonë që ka marrë pjesë në Olimpiadën e gjuhës shqipe në Kosovë-Shqipëri, dhe ka arritur me nxënë vendin e tretë. Si komunë, kjo është një arritje e mirë dhe e kënaqshme, dhe kjo është indikacion që këtu po zhvillohet mësim me standarde normale. Tjetra, për shkak të ligjit, pagat e drejtorëve shumë pak dallojnë me pagat e arsimtarëve, për këtë arsye nuk ka shumë interesim për me u bërë drejtor. Ka shkolla kur hapet konkursi dhe ka shumë pak të interesuar me u bërë drejtor, kështu që nuk janë edhe mundësitë shumë të mëdha për me bërë një selektim, i cili duhet me u bërë nga radhët e kandidatëve që aplikojnë. Tani kemi me i hapur konkurset, të shohim se kush po aplikon.

**z. Jeton Luma:** Unë e kuptoj çështjen e selektimit, nuk jam kundër se kush përzgjidhet, por duhet me ruajtur kredibilitetin drejtorët. Nuk duhet me qenë domosdo drejtorët me tepër në rrjete sociale sesa në shkolla. Ata duhet me bërë punën e tyre. Sa i përket pagës, ligji e ka përcaktuar, askush nuk besoj se emërohet në pozitë të drejtorit kundër vullnetin e tij, por çështja është me ruajtur kredibilitetin e institucionit me të rëndësishëm të shoqërisë sonë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kjo çështje po diskutohet çdo vit kur po formojmë një komision të tillë, ndërkaq nuk është mirë me qenë paragjykes. Ndoshta ky diskutim duhet të bëhet kur të zgjidhen drejtorët, se a janë politikë apo jo, se ne paraprakisht po paragjykojmë se kush ka me ardhur drejtor. Unë nuk po paragjykoj, e ju nëse keni ndonjë informatë, është mirë me treguar se kush po përgatitet me ardhur drejtor, pastaj merr kuptim debati. Përndryshe, ky është një propozim vendim i cili nuk bëhet vetëm nga komuna jonë, por në bazë të një neni të një akti të nivelit qendror. Nëse nuk na përgjigjet ai nen, mundemi me bërë ankesa dhe me ndryshuar nenin e atij akti dhe ma vazhduar me procedurat që na përshtatën komunave.

**z. Jeton Luma:** Unë nuk po paragjykoj.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nuk e pata me juve aspak, kështu që nuk ka nevojë për replikë.

**z. Jeton Luma:** Unë nuk po paragjykoj, por po flas për përvojën e kaluar të afërt.

**znj. Ardita Rrahmani:** Pajtohem me juve, se edhe në mandatin e kaluar ka qenë ky shqetësim, por që në momentin që është propozim vendim, nëse keni diçka konkrete është mirë me thënë, nëse jo, ajo është supozim. Unë të paktën, në pritjet e mia e vlerësoj si paragjykim. Ndoshta ju keni të drejtë, atëherë i jepni argumentet e juaja.

**z. Gazmend Bunjaku:** Të përbërja e komisionit, ju njoftoj se duhet të respektohet edhe kuota gjinore, andaj njëra anëtare e komisionit është e gjinisë femërore, se nuk e dimë si kanë me qenë anëtarët nga ministria. Sipas ligjit, një anëtarë duhet me qenë nga DA, anëtari i dytë duhet me qenë një ekspert arsimor.

**z. Jeton Luma:** Unë nuk po flas për drejtorët që kanë me u zgjedhur, po flas për praktikën e kaluar. Kërkoj që kjo mos të ndodhë në të ardhmen,. Unë nuk e di se kush ka me ardhur as nuk paragjykoj as nuk i njoh anëtarët e komisionit.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për, Kundër votë 5- LVV. Abstenim nuk ka Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### **VENDIM**

**Për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore/Lënda: 01Nr.04-610/01-11559/26.**

**5. Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026;**

**Kryesuesi i Kuvendi:** Fjalën e ka drejtori i DBF, Valdrin Dogani

**z. Valdrin Dogani:** Para juve e keni Propozim Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026, me ia bashkëngjitur buxhetit të vitit 2026. Të HVK janë e drejtë ekskluzive e komunave, vendosin ku me i shpërndarë në bazë të aktiviteteve dhe shërbimeve. Janë dhënë në propozim vendim të dhënat e detajuara si dhe në tabelat përcjellëse që iu kanë bashkëngjitur materialit. Shuma për bartje është 430,535.34€. Këto mjete do të bartën në këto programe buxhetore, Mallra dhe Shërbime, shuma 102,282.04€, Shpenzime Komunale, shuma 54,808.58 €, Subvencione dhe Transfere, shuma 35,000.00€ dhe Investime Kapitale, shuma 238,444.72€. Të HVK të vitit 2025, planifikimi ka qenë 950 mijë, kemi inkasuar direkte dhe indirekte, tejkalim 87 mijë euro. Sesi bëhet shpërndarja e mjeteve të bartura, janë dhënë sqarimet, për pyetje përgjigjem.

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin:

**z. Islam Gashi:** Totali i bartjes se mjeteve vetanake është mbi 430 mijë euro. Nga këto mjete mbi 118 mijë euro janë të bartura nga viti 2024, ndërsa mbi 311 mijë janë të vitit 2025. Nga shuma e përgjithshme e mjeteve të bartura, shumës mbi 430 mijë euro, shihet se mbi 277 mijë euro janë të bartura kryesisht nga kategoria e investimeve kapitale, që paraqet rreth 64%. Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të bartura do të shpenzohen për shpenzime

operative në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale. Kjo paraqet problem, se te të HVK kishte qenë mirë të barten në investime kapitale, pasi që shpenzimet operative duhet të mbulohen nga buxheti i rregullt. Kur komuna fillon të mbështetet të bartja e mjeteve për funksionimin e komunave për zhvillimin bazik administrativ të saj, atëherë të bënë me kuptuar se keni dështuar në planifikimin e buxhetit. Nëse krahasojmë tabelën 3 dhe tabelën 4, në tabelën 3 paraqiten rastet ku janë krijuar tepricat, ndërkaq tabela 4, ku do të dërgohen këto mjete, atëherë vërehet trend shqetësues i zhvendosjes së mjeteve nga investimet kapitale drejt shpenzimeve operative. Në tabelën me nr. 3, bilanci i pashpenzuar të kategoria e mallrave kanë qenë 36 mijë euro, ndërkaq me rishpërndarje 102 mijë euro, rreth 66 mijë euro me tepër. Të Shpenzimet komunale 7,770 euro kanë qenë, tani me rishpërndarje mbi 54 mijë euro, që i bien plus 47 mijë euro me tepër. Të Subvencionet dhe transferet, 21 mijë euro, ndërkaq me rishpërndarje 35 mijë, ndryshim plus 13 mijë euro. Të investimet kapitale, 277,560 euro, me rishpërndarje 138 mijë euro apo një zvogëlim për 39 mijë euro dhe kanë me u shpenzuar për kategoritë tjera. Të kodet buxhetore, sektori i bujqësisë, nga transferet dhe subvencionet janë tërhequr rreth 16 mijë euro. Të çështjet gjinore kanë ngelur 16 mijë euro, ndërkaq në këtë vit nuk ka asnjë. Këto mjete janë zhvendosur të kategoria e administratës. Të shërbimet kulturore mjetet e pashpenzuara rreth 5 mijë euro, kjo shumë është bartur . Pyetje, Pse mjetet e vitit 2024 në vlerë 119 mijë euro, nuk janë shpenzuar në vitin 2025, por po bartën për shpenzim në vitin 2026?

**Valdrin Dogani:** Të pyetja e fundit, me bartjen e mjeteve 430 mijë euro, krijohet fondi 22, dhe janë të hyrat e vitit 2025. Në vitin 2027, përsëri na paraqitën që janë të vitit 2025.

**z. Islam Gashi:** Pse mjetet e vitit 2024 në vlerë 119 mijë euro, nuk janë shpenzuar në vitin 2025, por po bartën për shpenzim në vitin 2026?

**Valdrin Dogani:** Janë shpenzuar mjetet sipas aktiviteteve të parapara, por mjetet që nuk janë shpenzuar, e kemi të drejtën ekskluzive me i bartur. Sivjet jemi duke i bartur diku 430 mijë euro, vitet tjera janë bartur me tepër. Me dashur ekzekutivi përmes KK duke tentuar me bërë një projekt me të madh. Kjo është politikë e jona. Vitin e kaluar janë bartur mbi 1 milion euro, në këtë vit 430 mijë euro, që po del se janë shpenzuar me tepër. E përmende se janë bartur mjetet prej investimeve kapitale. Ju doni me ditur ngritjen e çmimit, duhet me kuptuar rritjen e pagave minimale. Fjala vjen, të kontrata me kompaninë për sigurim fizik të objekteve, të gjithë atyre punëtorëve iu ngritët paga në janar dhe në korrik, kjo kërkon amandamentim të kontratës. Të komunalitë, a e dini sa është ngritur çmimi i rrymës. Prej kapitaleve nuk është vlerë e madhe që dallon, kryesorja është përmbushja e obligimeve sipas kontratës dhe detyrimeve të pa paguara.

**z. Islam Gashi:** E more shembull rrymën, unë nuk e di që është rritur rryma prej shtatorit të vitit të kaluar kur e keni hartuar buxhetin. Rryma është rritur para shtatorit për 16%. Ju është dashur me bërë një rritje që 16% kemi me i pasur shpenzimet e rrymës me të larta. Është dashur me i paraparë në buxhetin e rregullt, e jo mjetet që nuk janë shpenzuar nga investimet kapitale me i bartur. Tjetra, infrastruktura rrugore kanë qenë 116 mijë euro që nuk janë shpenzuar në vitin 2025, ndërkaq vetëm 15 mijë janë në këtë vit.

**z. Valdrin Dogani:** Kjo është analizë e buxhetit që e bëjmë ne. Të shërbimet publike, buxheti i vitit 2026 janë projektet kapitale që i ka planifikuar drejtorja me i krye dhe nuk ka pasur mjete për bartje. Përveç projekti i trotuarit dhe ndriçimit publik i rrugës “Fadil Bunjaku”, nëse nuk gaboj, mjetet tjera i ka drejtori, i cili veç se ka filluar me zhvillimin e procedurave.

**z. Islam Gashi:** Të kategoria e bujqësisë, tabela 3, të subvencionet kanë qenë 16,333 euro që janë bartur, ndërkaq në tabelën 4 nuk keni bartur asnjë. Ku janë bartur këto mjete?

**z. Valdrin Dogani:** Me buxhetin e vitit 2026 nëse e keni analizuar, kemi mjete të ndara të subvencionet e bujqësisë.

**z. Islam Gashi:** Pse nuk i keni rritur mjetet të subvencionet e bujqësisë, a nuk po kanë nevojë fermerët për mjete, e jo me i bartë mjetet që janë për zhvillim, në mallra e shërbime?

**z. Valdrin Dogani:** Janë politikat tona, ne i vendosim ato. Jeni dëshmitarë që çdo vit përmes DBPZHR, organizatave të ndryshme, e kemi subvencionuar fermerin, bujkun. Shuma e ndarë për subvencione në bujqësi në vitin 2026, mendoj se është e mjaftueshme për me i përmbushur kërkesat e buqëve.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Po ndërlidhem të bashkëbisedimi i Islamit me drejtorin, pse nuk janë shpenzuar mjetet e vitit 2024. Përgjigja e drejtorit është, nuk ka pasur nevojë. Mjetet kanë qenë të destinuar për qëllime të caktuara. A po i bien që këto mjete që i kemi destinuar në këto tabela, prapë nuk ka nevojë, por i keni destinuar veç me i bartur apo po prisni me i bërë ato politikat e juaja që nuk po i kuptojmë sa duhet.

**z. Valdrin Dogani:** Fundi i vitit tregon sa kemi shpenzuar, sa kemi kursyer, a janë përmbushur objektivat tona. Vitin e kaluar askush nuk e ka përmendur se GQ është shpenzuar 99.9%. Të HVK janë e drejtë ekskluzive e komunës se ku i shpenzon, se ato të hyra i inkason vet komuna. Të planifikimi i komunalive, planifikimet fillojnë nga muaji maj. Nga maji qershor vendosen kufijtë buxhetor, që votohet në fund të muajit shtator, d.m.th. me herët se kur mendove se është ngritur çmimi i energjisë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** A ka nevojë për këto orientime të mjeteve të bartura në projekte të caktuara, apo vetëm po i bartni, se nëse mjetet e vitit 2024 janë bartur në vitin 2025 dhe nuk janë shpenzuar, përgjigja juaj ishte se nuk ka pasur nevojë. Pyetja është se qytetarët mund të jenë të interesuar me i pa ku bartën mjetet, dhe rrinë me shpresën se kanë me u realizuar, ndërkaq prej përgjigjes suaj që po thoni se nuk keni pasur nevojë, po i humbin shpresat.

**z. Islam Gashi:** Të hyrat vetanake u tha se shpresojmë se nuk na merren, ato nuk merren vetëm bartën. GQ është shpenzuar 99%, por pjesën me të madhe e marrin pagat, janë shpenzimet e planifikuara me buxhet. Ju po thoni se të këto kategori nuk ka pasur nevojë shpenzimi i tyre, ndërkaq Begraca ka nevojë për fushë të futbollit, trotuare, kanë nevojë fshatrat për ndriçim publik. Pse nuk i keni destinuar këto mjete me i plotësuar nevojat e qytetarëve, por i keni destinuar ku nuk ka pasur nevojë?

**z. Bashkim Krasniqi:** Po ndërlidhem me temën që është çështje debati. Ju po bëni aq shumë pyetje, sa që tërë kohën e provokoni drejtorin, veç me nxitur me lëshuar një fjalë dhe me u kap për atë fjalë. Shumica e mjeteve janë bartë për investime kapitale. Ju kolegë e potencuat se a ka nevojë bujqësia për mjete, bujqësia ka nevojë për mjete, tek e fundit në komunën tonë po i dërgojmë këto mjete, e nuk po i dërgojmë në aeroporte me udhëtuar njerëzit.

**znj. Ernesta Krasniqi:** A ka mundësi me debatuar vetëm për çështje lokale?

**z. Bashkim Krasniqi:** Ju nuk mundeni me më treguar se çka foli unë. Mjetet janë bartur nga të HVK, ndërkaq është politikë e komunës ku i orienton. Pse ky mlllef kaq i madh. Drejtori i dha krejt përgjigjet në pyetjet që u ngritën në këtë pikë, ndërkaq ju përsëri bëni

pyetje. A po doni drejtori me ju lexuar krejt propozim vendimin. Lexoni materialin, se janë të dhënat. Ju po bëni pyetje, po ju epën përgjigjet, por nuk po ju pëlqejnë. Pse po bëni pyetje, kur nuk e pranoni përgjigjen që po ju epët?

**z. Islam Gashi:** Politika e komunës nuk është me i orientuar mjetet ku doni ju, por ku janë nevojat, e jo me i bartur vit pas viti. Ju po thoni se ka inflacion, inflacion ka me pasur çdo vit. Tani vlera e 1 euro e vitit 2024 nuk ka me pasur vlerën e vitit 2025. Për atë me mirë është ato mjete nëse nuk ka nevojë bujqësia, me i orientuar në projekte kapitale, si trotuar etj. që njerëzit mos të jenë të rrezikuar në mungesë të trotuareve, apo me i orientuar në ndriçim publik, e në rrugë, e jo me blerë tavolina apo printera me ngjyrë (po supozoj). Për ua me mirë me ndërtuar një trotuar për siguri të fëmijëve në shkolla, sesa me ma blerë një tavolinë të re për asamble komunale, por pasi qenka politikë e komunës orientimi i mjeteve, në rregull atëherë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Keni kaluar me tepër se 10 minuta, ju dhamë hapësirë, por përsëri po mendoni se nuk po ju japim hapësirë të mjaftueshme.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Po ndërlidhem me diskutimin e kolegut që tha se po provokoni. Po me shqetëson fakti kur po iu pengon diskutimi i një pike shumë të rëndësishme. Kjo nuk besoj se e po e bezdisë drejtorin, se ai është përgjegjës për këtë punë, por po me shqetëson fakti kur nuk iu pengon kolegëve, kur thotë se nuk ka pasur nevojë me i shpenzuar. Secili nga ne vijmë prej vendeve të ndryshme, e vizitojmë Kaçanikun me rrethinë dhe e shohim se ka nevojë për projekte. Po ju pengon pse ne bëjmë pyetje dhe e elaborojmë këtë pikë, por nuk iu pengon kur drejtori thotë se nuk ka pasur nevojë për shpenzimin e atyre mjeteve të vitit 2024. Unë mendoj se edhe ju duhet me bërë pyetje, pos sa po e shoh nuk i keni kuptuar sa duhet çka ka thënë, po besoj se nuk e keni lexuar as materialin.

**z. Xhelal Ceka:** Kryesues, mos i lejo me folur jashtë rendin të punës. Nuk mundeni ju me na treguar neve a e kuptojmë materialin apo jo. Tjetra, po ngjiteni për fjalën e drejtorit. Kush ka punuar në ndërmarrje publike, e dinë se këto punë shkojnë përmes procedurës së tenderimit. Procedurat e tenderimit ka gjasa të vonesave, prishjes së tenderit, shtyrjes së tenderit, ankesave apo të ngjashme. Me na treguar neve se a kuptojmë apo jo, unë mos me kuptuar, nuk iu dëgjoj. Kush jeni ju me na treguar neve a kuptojmë apo jo.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos të kalojmë nga rendi i punës, fjalën e ka kryetari i komunës, Sabedin Vishi:

**Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Përshëndetje për të gjithë, shfrytëzoj rastin me uruar KF Lepenci inkuadrimit në ligën e I (parë), na ka bërë krenar të gjithëve si komunë e Kaçanikut. Po ndërlidhem të pjesa e fundit të mjetet e bartura, mendova se ka me potencuar dikush nga ju për një planifikim me të mirë dhe bartje me të vogël të mjeteve në krahasim me vitin e kaluar, ku janë bartur mbi 1 milion euro, ndërkaq sivjet janë 430 mijë euro. Te ekzekutimet ka ndonjë mungesë të realizimit të objektivave siç është në secilin dikaster, qoftë në nivel lokal apo qendror. Të rritja e shpenzimeve komunale e dimë impaktet dhe indikatorët, pse janë rritur këto shpenzime enorme dhe është dashur në bazë të vendimeve që janë marrë për ngritjen e çmimeve dhe të energjisë, na me i zbatuar që mos me i mbetur borgj, se ne nuk mundemi me funksionuar me na u ndalë energjia si rezultat e borgjeve, kur e dimë sa shërbime bëhen në komunë, QKMF dhe institucione tjera. Prandaj, ne duhet me planifikuar me kohë si rezultat i ngritjes së energjisë, me bërë planifikim me bartje të mjeteve, edhe pse hera tjera edhe kur nuk është bërë planifikimi i mirë, kemi pasur mundësi me bërë rishikimin e buxhetit, jo vetëm ne, Islami mundet me ditur me mirë, gjithmonë ka

pasur rishikim të buxhetit, se nuk mundemi me planifikuar orientimet buxhetore 100%, dhe nuk mundemi me i arritur objektivat as ne as ju 100%. Prandaj, gjithmonë ka ekzistuar rishikimi buxhetor, ku kemi pasur mundësi me i përmirësuar aty ku nuk kemi mundur me i arritur objektivat, e që përsëri nuk kemi mundur me i arritur. Nëse e keni kuptuar mirë, janë dy kode buxhetore, kodi 21 dhe të HVK të vitit të kaluar dhe kosi 22, që janë të vitit aktual. Tani kur të bëhet planifikimi buxhetor, kemi me pasur debate publike, debat edhe në KK, ku bëhen propozime për projekte sipas buxhetit të vitit 2027 dhe ne gjithmonë i parashohim prej GQ dhe të HVK. Kur jemi te të HVK, për projekte është dashur me hapur procedurën e tenderimit, me i pasur të zotuar mjetet edhe për të HVK të vitit aktual. Ne nuk mundemi me i ecur procedurat si rezultat i këtij vendimi, se duhet me prituri deri sa të arkëtohen të HVK në kodin 22. Të kodi 21, të HVK bartën për 1 vit paraprak, ato mjete kur janë bartur në vitin 2025, ka mundësi të “x” projekti konkret që iu ka shkurtuar projekti që nuk ka mundur me realizuar dhe është dënuar. Tani në prioritet i japim GQ në fund të vitit, me realizuar 100%, për shkak se kthehen mjetet në qeveri në suficit buxhetor. Kështu ne mundohemi me realizuar buxhetin sa me tepër nga GQ dhe projektet nga mjetet e bartura. Drejtorit ka mundur me ikur fjala, se nevoja ka komuna. Të gjitha kërkesat edhe të pozitës edhe të opozitës janë të arsyeshme, ndërkaq a janë të mundura realizimi i të gjithave, jo nuk janë. Ju e dini që ne publikisht e kemi thënë se një terren sportiv do të realizohet në Begracë, e dinë edhe krejt Begraca, e dinë edhe Buletini për pyetjen që ka ngritur për terrene sportive, por nuk ka problem. Ju jeni këtu me i përfaqësuar kërkesat e atyre që iu kanë sjellë këtu, dhe është mirë që i ngritë, por vetëm prita me thënë që është pak me mirë çështja e bartjes se mjeteve sesa herëve tjera, ndërsa ne jemi këtu me dëgjuar secilin duke u nisur nga vetja, kryesuesi dhe gjithë tjerët.

**znj. Kadrije Lika Troni:** A mundet me u bërë rishikim të buxhetit të vitit 2026?

**Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi:** Jo, rishikimi buxhetor bëhet me vendim të ministrisë. Viteve të mëhershme janë bërë rishikime buxhetore, ndërkaq tani ka vite që nuk ka rishikim të buxhetit për me i orientuar buxhetin.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 11 votë Për, Kundër votë 5- LVV. Abstenim 3-VZHK. Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

**Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në Buxhetin e Komunës për vitin 2026/ Lënda: 01Nr. 400/01-11669/26.**

5.Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Bob;

**Kryesuesi i Kuvendi:** Fjalën e ka drejtori i DUKKMM, Korab Krasniqi

**z. Korab Krasniqi:** Ky propozim vendim është iniciuar me qëllim që të krijohet trotuar në një pjesë të rrugës dhe këmbimin e pronës sipas kërkesës së datës së caktuar. Pjesa që këmbëhet është me e madhe sesa i jepet personit fizik. Nuk kemi kushte teknike për me pa me projektor. Pjesa me të verdhë është prona e personit fizik, ndërsa me ngjyrë të kuqe është pronë komunale. Të pjesa e personit fizik, në njërin anë është rruga, pjesa ku bashkohen dy rrugë dhe në pjesën tjetër që është me e gjatë, është trotuari. Mendoj që është interes i komunës me u bërë ky këmbim, në mënyrë që edhe rruga edhe trotuari të kalojnë në pronësi të komunës. Besoj se isha i qartë dhe nuk besoj se kishte me pasur ndonjë problem në këtë rast.

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin:

**z. Bashkim Krasniqi:** Këtë propozim vendim Kjanu e ka elaboruar në KPF aq mirë, kështu ne subjekti politik i PDK jemi Për me mbështetur.

**z. Kjani Zeneli:** Unë edhe në KPF e kam elaboruar, pasi që jetoj atje dhe e njoh mirë atë terren. Këtu interesi është me i madh i komunës sesa i personit fizik, kështu që ne si VZHK e mbështetim plotësisht.

**z. Jeton Luma:** Këtu ishte ajo vërejtja që unë në fillim u ndërlidha në fillim, janë mbuluar ID, por në fund lënda e ka fotot e ID. Nëse na vijnë vetëm neve, në rregull është se ne jemi zyrtar komunal, por kur publikohet në facebook të komunës, atëherë kjo mundet me na penalizuar si komunë.

**z. Korab Krasniqi:** Në këtë rast informata zyrtare nuk shpërndahen, besoj se zyrtarja e KK është e kujdesshme dhe nuk i ka bashkangjitur. Kemi kujdes në këto raste, kërkoj falje nëse është përvjedhur ndonjë gabim.

**z. Jeton Luma:** Zyrtarja e KK e bënë një punë të mrekullueshme, për atë e vlerësoj shumë, por janë probleme teknike, çështja është mos me vazhduar në të ardhmen. Sapo e kontrollova një link të materialit të një mbledhje, aty se bashku me lëndën i janë bashkëngjitur emrat dhe numrat personal.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim 5-LVV. Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

**Për Shpallje me interes publik të Parcelës Kadastrale 00304-0 në ZK Bob, për krijimin e një trotuari dhe një pjese të rrugës/ Lënda: 01Nr. 350/02-11735/26.**

**6.** Propozim Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e komunës së Kaçanikut si dhe Emërimit e Objekteve komunale;

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** Unë edhe në KPF e potencova se çështja e emërimit të rrugëve, është mjaft e ndieshme. Komisionin e pret një punë jashtëzakonisht e madhe me përgjegjësi të madhe, se këtu ka me pasur emërime të dëshmorëve dhe të figurave të njohura kombëtare në komunën tonë. Unë kërkoj me pasur një qasje me komunitetin që kur të bëhet një emërim i rrugës, të bëhet çdo herë me pëlqimin e tyre, se mund të anashkalohet ndonjë informatë ose njoftim për një emërim të rrugës, pastaj të ngecin komisioni në adresimin e asaj rruge.

**z. Bashkim Krasniqi:** Unë mendoj që ky komision duhet me që shumë përgjegjshëm, se në komunën tonë ka shumë rrugë që janë në kontest sa u përket emrave. Komisioni duhet me qenë edhe serioz edhe me i shikuar të gjitha gjërat, se mundet me pasur kërkesa të njëanshme, dikush donë me emërtuar një rrugë ndryshe, tjetri ndryshe, mendoj se duhet me u zgjedhur një komision shumë serioz që i merr parasysh krejt gjërat dhe mos me pasur probleme në të ardhmen.

**z. Kjan Zeneli:** Edhe unë mendoj që në këtë komision me u përfaqësua edhe shoqatat e dala nga lufta, për shkak se kemi disa rrugë që janë emëruar, janë hequr pllakatet, kemi

pasur edhe rastin e fundit, që e falënderoj kryetarin e komunës që na ka pritur me atë familjen Dogani që e kemi pasur atë kontestin, me zgjidhur, por nuk është zgjidhur ende. Për atë e shoh shumë të nevojshme përfaqësimin e OJQ të dala nga lufta e UÇK në këtë komision.

**z. Jeton Luma:** I bashkëngjitëm kërkesës së kolegut, për përfaqësim në komision anëtar nga OJQ e UÇK-së.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Gjithsesi, veç është paraparë përfaqësimi i OJQ-ve të dala nga lufta. Nëse nuk ka kush diçka tjetër, shkojmë me propozime konkrete. Fjalën e ka drejtori i DUKMM, Korab Krasniqi me dhënë propozime për anëtar të komisionit nga ekzekutivi.

**z. Korab Krasniqi:** Nga ekzekutivi i komunës i propozojmë për anëtarë të komisionit: Rakip Vishi dhe Visar Mulaku.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Nga subjekti politik i PDK, jepni propozimin.

**z. Bashkim Krasniqi:** Nga PDK e propozojmë për anëtarë të komisionit të jetë, Xhelal Ceka.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Nga LVV jepni propozimin.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nga LVV ne e propozojmë Enis Vishi. Desha me cekur se a e keni paraparë përfaqësimin gjinor në këtë komision?

**z. Korab Krasniqi:** Nuk është obligative me qenë patjetër përfaqësimi gjinor.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Është obligative që në çdo komision me qenë përfaqësimi gjinor, kërkoj nga ekzekutivi me pasur një përfaqësim gjinor.

**z. Korab Krasniqi:** Është ideale me qenë në këtë komision.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Me kënaqësi kisha marrë pjesë në këtë komision, por unë dhe Kadrija jemi anëtare të KPF dhe nuk mundemi të jemi anëtare të këtij komisioni, kështu që ju takon juve me bërë një propozim nga struktura gjinore femër.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nëse ka nevojë bëjmë pauzë 5 minuta, se ndoshta duhet me u konsultuar me kandidatin për anëtar të komisionit.

**z. Kjani Zeneli:** Në emër të OJQ shoqëria civile të dala nga lufta e UÇK, e propozoj të jetë Burim Bunjaku.

**znj. Ardita Rrahmani:** A duhet OJQ me u koordinuar me sjellë një emër, apo duhet dikush prej KK me propozuar prej shoqërisë civile?

**Kryesuesi i Kuvendi:** Mirë Kadrije që e potencove, atëherë shkojmë me një propozim nga ekzekutivi.

**z. Korab Krasniqi:** Atëherë nga Ekzekutivi e tërheqim anëtarin e propozuar Rakip Vishi, e caktojmë Ardita Shehu-Raka.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Atëherë Propozimet për anëtarë të komisionit i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtin u aprovuan njëzëri. Prezentë 19. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### VENDIM

**Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut si dhe Emërtimin e Objekteve Komunale, në përbërje:**

- |                              |  |
|------------------------------|--|
| <b>1.1 Visar Mulaku,</b>     | <b>anëtar (Ekzekutivi)- Zyrtar në DUKMM</b>  |
| <b>1.2 Ardita Shehu-Raka</b> | <b>anëtare (Ekzekutivi)- Zyrtare në DUKMM</b>  |
| <b>1.3 Xhelal Ceka</b>       | <b>anëtar i Kuvendit nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK</b>                                |
| <b>1.4 Enis Vishi</b>        | <b>anëtar i Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje-LVV</b>  |
| <b>1.5 Burim Bunjaku</b>     | <b>anëtar nga Shoqëria civile/ OJQ të dala nga lufta e UÇK/Lënda: 01Nr. 104/02-11729/26.</b> |

7. Draft Rregullore për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendi:** Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Arian Tenaqja.

**z. Arian Teneqja:** Rregullorja është hartuar nga grupi punues në kuadër të ligjit për transport rrugor, ka për qëllim zhvillimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, ku përcaktohen kompetencat e komunës në rregullimin e transportit rrugor të udhëtarëve, procedurat për licencimi i kompanive të operatorëve, ofrimin e transportit rrugor, certifikimin etj. Kjo rregullore nevojitet për kompletimin e legjislacionit të komunës, prandaj kërkoj që të votoni.

**Kryesuesi i Kuvendi:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** Unë edhe në KPF e kam potencuar transportin e nxënësve sidomos të f. Llanishtë dhe të f. Gllloboçicë, që janë në largësi, megjithatë rregullorja nuk na lejon me ndërhyrë. Në kuadër të kësaj, a kemi mundësi me përmirësuar rregulloren, që me zbrit 2 apo 1 km kompensimin e udhëtimit të nxënësve. Besoj që krejt pajtoheni.

**z. Arian Teneqja:** Ajo që po e thoni ju, nuk është në kuadër të kompetencave të kësaj rregulloreje. Kjo rregullore i përcakton format e licencimit të operatorëve, mënyrat sesi merren linjat. Pastaj, në bazë të kësaj rregulloreje shqyrtohen kërkesat. Ajo pjesa e subvencionimeve trajtohet në një nivel me të gjerë dhe ka implikime buxhetore.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Nuk është fjala të kompensimi, por çështja është që nxënësit që vijnë nga vendet në largësi me pasur një linjë të rregullt.

**z. Arian Teneqja:** Ato linja nëse duhet të shqyrtohen në bazë të kësaj rregulloreje.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Nëse ndryshon km për pagimin e udhëtimit të nxënësve nga 4, në 2 fjala vjen, atëherë kjo vlen për krejt nxënësit që udhëtojnë.

**z. Jeton Luma:** Po ndërlidhem me punën e distancës prej 4 km. Unë e kam marrë përgjigjen prej drejtorit në pyetjen që kam ngritur. Unë e kam vërtetuar se bëhet fjalë për një distancë

mbi 4 km. A mendoni se duhet të licencohet apo të tenderohet ndonjë kompani që e rregullon këtë çështje?

**znj. Ardita Rrahmani:** Mendoj nëse ka interes kompania, aplikon, pastaj shqyrtohet. Komuna mundet me zhvilluar procedurat, por nëse nuk aplikon askush, qysh duhet me ia bërë sipas juve, kush është fajtori, ai që nuk aplikon apo komuna?

**z. Enis Vishi:** Duhet me ofruar si mundësi, ndërkaq nëse nuk aplikon ajo është çështje tjetër.

**z. Jeton Luma:** Edhe me ligjin e ministrisë së arsimit është e rregulluar që në distancën mbi ose afër 4 km Komuna është e obliguar me ligj me ia mbuluar nxënësit transportin. Përtej licencimit të komunës operatorin, komuna është e obliguar të rregulloj këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Këtë problem e kemi edhe në f. Kovaçec, operatorët ekonomik nuk i kanë llogaritë e veta dhe kemi mbetur pa transport të nxënësve, se nuk vjen askush me i marrë.

**Kryetari i Komunës:** Nëse ju kuptova drejt, zonjën Kadrije që me i shkurtuar km për me i subvencionuar nxënësit që udhëtojnë me pak se 4 km që me pasur mundësi me u përfshirë ata nxënës. Kjo rregullore është e komunës për hapjen e linjave të reja, por nëse gjithmonë ka leverdi operatori ekonomik se ne nuk e pengojmë nëse ka interes që ia japim në bazë të rregullores. Ajo tjetra rregullohet në bazë të Udhëzimit Administrativ-UA nga MASHT. Nëse ata bëjnë ndërhyrje me i kompensuar udhëtimin e nxënësve 3 km, ne obligohemi me zbatuar. Nëse ata e lënë UA ashtu mbi 4 km, atëherë ne veprojmë sipas tij. Për f. Gllloboçicë, përgjigjen nuk e di si ta ka dhënë përgjigjen, vetëm e di saktësisht se ka rrugë alternative të asfaltuar me të shkurtër në atë pjesë.

**z. Jeton Luma:** Unë i kam paraqitur me fakte sikurse herën e kaluar, edhe pse me ndërhyri kryesuesi, këtë e dinë edhe Xhelali, se është i lagjes Kodrali. Bëhet fjalë për një fëmijë që vjen nga lagja Kodrali, mbi të gjitha është fëmijë me nevoja të veçanta, udhëton në 4.16 km. Një fëmijë tjetër udhëton tjetër i lagjes Dragomas, udhëton 4.65 km. Nuk është kjo në vijë ajrore. E kam matur në gjeoportal, rrugën që bënë automjeti për me dërguar nxënësi në shtëpi. Nëse është ajo rrugë nën 4 km, unë e tërheqë kërkesën time dhe nuk bëjë asnjë kërkesë. Unë e kam matur rrugën me Google MAPS.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Rruga alternative është e asfaltuar dhe është e kalueshme.

**z. Jeton Luma:** Nëse është ajo rrugë nën 4 km, unë e tërheqë dhe nuk bëjë asnjë kërkesë. Unë e kam matur rrugën me Google MAPS.

**z. Xhelal Ceka:** Të pjesa e rrugës Kodrali, duhet me dal në Dragomas për me shkuar të shkolla. Ne kur jemi shkolluar, kemi udhëtuar këmbë në ato rrugë për në shkollë. Pjesa e lagjja e re që e keni potencuar, është shumë larg. Unë kisha thënë me gjetur një zgjidhje. Nëse nuk i ka 4 km, me përshkua rrugën kah lagjja e re dhe me i bartur ata nxënës nëse është mundësia. Çështja është se a ka të interesuar me i bartur, përndryshe e meritojnë me i bartur, kjo nuk diskutohet.

**Kryetari i Komunës:** Nëse nxënësi është me aftësi të kufizuara, ata nxënës e kemi obligim me i bartur, qoftë edhe në Prizren nëse është fjala. A e keni matur rrugën që shkon kah kufiri, pjesa e rrugës që shkon kah shkolla, se unë kam vizituar ato pjesë të rrugës? Tjetra, nëse rregullohet me UA, ne jemi duke ua paguar udhëtimin nxënësve të shkollave të mesme, për vitin vijues kam me kërkuar këtu në KK me ndarë buxhet, me ia mbuluar kompensimin

e shpenzimeve të udhëtimit nxënëse të shkollave të mesme nga Kaçaniku, që udhëtojnë për në Ferizaj drejtimet që nuk janë në Kaçanik.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Unë desha për me ua lehtësuar, me dhënë ide dhe mendim që me përmirësuar rregulloren, me zvogëluar km se Llanishta dhe Globoçica janë tepër keq për nxënësit, sidomos Llanishta janë të obliguar edhe prindërit me paguar 50% të transportit se komuna nuk po e siguron të njëjtin. Duhet me zgjidhur këtë problem komuna, mos me ua lënë barrë nxënësve transportin, se duhet dikush nga komuniteti me u ndalë nga puna me i bartur fëmijët, kur nuk qarkullon kombi apo nuk frekuenton. Kjo është shumë e rëndësishme me ua lehtësuar shkollimin nxënësve, se nxënësi kur lodhet, nuk është i aftë as me kuptuar mësimin.

**z. Jeton Luma:** Të sqarohemi së pari, nxënësi me nevoja të veçanta udhëton me mjetin e transportit që i bartë nxënësit e dy lagjeve, Dragomas dhe Kodrali. Nuk ka ndonjë transport të rregulluar, unë kam me u interesuar dhe të jap përgjigjen. Unë jam marrë një muaj ditë me këtë, i kam takuar prindërit, dhe atë që i bartë nxënësit. Të kam dërgua në Google MAPS, është një rrugë aty e shkurtër, por prapë është mbi 4 km, mund ta dëshmojë këtë. Transportuesi shkon kah kjo lagje deri të lagja tjetër zbret apo i merr nxënësit tjerë. Edhe nëse ia heq 0.5 km, përsëri është mbi 4 km. Nxënësi i lagjes Dragomas nuk ka rrugë alternative, ndërkaq nxënësi i lagjes Kodrali nëse përshkon atë rrugë, është mesjetë, kalojnë vetëm kafshët përmes asaj rruge, se është në pjerrtësi. Xhelali e përmendi se ne kemi udhëtuar këmbë në ato rrugë për në shkollë. E vërtetë është, përpara kanë udhëtuar nxënësit shumë km, qoftë edhe deri në Kaçanik, por tani jemi në një kohë krejt tjetër. Në shtator të vitit të ri shkollor, mendoj që kjo çështje ka me u zgjidhur. Kjo barrë mendoj se i takon komunës, ndërkaq sesi e rregulloni çështjen me operatorin ekonomik është çështje e juaja. Unë e kam mirëpritur vendimin për transportin falas të nxënësve të shkollave të mesme, megjithatë përtej kësaj ka një tejkallim, shkollimi i mesëm nuk është obligativ, ndërkaq shkollimi fillor është obligativ. Me ligj është e rregulluar që transportin me ia siguruar nxënësit të shkollës fillore, jo atyre të shkollave të mesme, por është krejt në rregull që po iu bëhet kompensimi.

**Kryetari i Komunës:** Nëse largësia është mbi 4 km. në rregull është Jeton, unë vetëm pyeta a e keni matur? Pasi që nxënësi është me aftësi të kufizuara, nëse nuk kemi mundësi me ua mbuluar edhe tjerëve, të adresojnë një kërkesë prindi i vet në zyrën e kryetarit për subvencionim të transportit dhe kjo kryhet. Ndërkaq çështja se kush i bartë është tjetër.

**z. Gazmend Bunjaku:** Të pjesa e Llanishtës, ne e mbulojmë udhëtimin për nxënësit e shkollës fillore, por jo për nxënësit e shkollave të mesme, se është nën 4 km, se janë të rritur me kaluar atë rrugë. I dimë vështirësitë që munden me i pasur për shkak të terrenit, por krijon precedentë për vendet tjera dhe nuk do të kemi mundësi me i mbuluar. Për këtë duhet një analizë pak me të thellë kur thuhet me i shkurtuar km. A kemi mundësi financiare me i mbuluar, plus po janë marrëveshjet me operatorët, janë linjat që nuk po kanë interes operatorët, por duhet me angazhuar operatorë privat, e po kanë kërkesa të larta financiare dhe kjo i kushton komunës. Kur themi me i shkurtuar km. duhet me pasur njohuri sesa po krijon precedentë kjo, se nëse ua kompensojmë shpenzimet e udhëtimit nxënësve të f. Llanishtë, kërkoj t'iu bëhet edhe atyre nga fshatrat tjera, si Doganaj, Elezaj etj. sepse të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Drejtor, kur flasim për f. Llanishtë, në këtë fshat është mbyllur shkolla, ndërkaq shkolla nuk është mbyllur në Elezaj. Nxënësit e f. Elezajt e kanë afër

shkollën, nuk e kanë mbi 2 km. Prej cilit muaj drejtor ka filluar me u mbuluar shpenzimet e transportit 100% të nxënësve të f. Llanishtë?

**z. Gazmend Bunjaku:** Unë i mora si shembull f. Elezaj, ndërkaq prej kur kam filluar detyrën, kompensimi nxënësve të f. Llanishtë iu bëhet transporti 100%.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kur e keni marrë ju detyrën, kam thënë se iu mbulohen shpenzimet 50%. Unë kam me u interesuar, se ju me keni thënë se kemi me realizuar, ndërkaq nuk e paskeni pasur informatën e saktë. Unë në momentin që kam kontaktuar me qytetarët, e kam adresuar çështjen këtu.

**z. Gazmend Bunjaku:** Besoj se është në procesverbal, unë kam thënë kam me realizuar, por pasi ishte realizuar, nuk ka pasur nevojë me ndërhyrë.

**z. Arian Teneqja:** E mora fjalën me sqaruar, se u ngritën shumë çështje që nuk kanë të bëjnë me këtë rregullore, dhe kjo mund të ndikoj në votim. Kjo rregullore nuk i parasheh kërkesat që u ngritën. Ato kërkesa që trajtohen me vonë dhe janë të arsyeshme, por rregullorja e trajton ofrimin e shërbimeve, plotësimin e kriterëve që duhet operatori ti plotësoj për ofrimin e këtyre shërbimeve të transportit të personave dhe mallrave. Kjo rregullore nuk i përcakton kilometrat. Ato janë të përcaktuara me UA.

**z. Jeton Luma:** Jashtë kësaj pike, meqë i kemi dy kandidatë konkurrentë për Kuvendin e Kosovës, Kadrije Lika Troni dhe Korab Krasniqi, ju dëshiroj suksese. Suksese të gjithë kandidatëve nga komuna e Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Atëherë draft Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 13 votë Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim 5-LVV. Prezentë 18. Konstatohet se Kuvendi i Komunës,

#### **APROVOJ**

**Rregulloren për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 104/02-11672/26.**

**8. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik:**

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Kadrije Lika Troni:** Kjo pikë për të cilën kemi me diskutuar, për fat të keq në mbledhjen e fundit u tërhoq nga drejtori. Arsyet drejtori i dha në mbledhjen e KPF, ndërkaq këtu në KK na mbeti borgj me na treguar pse e ka tërhequr atë pikë? Neve na keni sqaruar në KPF, por tani në KK me ua sqaruar edhe anëtarëve tjerë pse është hequr kjo pikë, se kjo pikë është kthyer në KK pa asnjë përmirësim tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalën e ka drejtori i DUKMM, Korab Krasniqi:

**z. Korab Krasniqi:** Pika është tërhequr para 3 mbledhjeve, jo para kësaj mbledhje. Kur e kemi pasur në shqyrtim këtë çështje, e kemi pasur një kërkesë të palëve të përfshira në këtë çështje, që me iu dhënë hapësirë me diskutua mes veti. Edhe pse kur është propozuar, nuk ka pasur ndonjë kontest mes këtyre dy familjeve Begunca. Pas konsultimit kemi ardhur në përfundim se nuk ka ndonjë kontest në mes të këtyre dy familjeve. Prona që është kërkuar me u këmbyer, nuk ka asnjë masë të përkohshme, nuk ka asnjë procedurë gjyqësore që është

duke u zhvilluar për të. Prandaj konsideroj që nuk ka asnjë problem që kjo pronë me u shpallë me interes për këmbim. Nëse keni ju ndonjë informatë të tillë, kërkoj që të paraqitni.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Ne jemi këtu me iu ndihmuar qytetarëve, por mënyra dhe forma si kanë vepruar pushteti, janë shtruar rrugët, siç është rasti i këtij këmbimi, në Dushkajë, pa i përfillur rregullat dhe procedurat. Tjetra, duke i dhënë leje ndërtimi personit tjetër në Bulevardin "Ismail Raka" ku 1m2 është në pronë të komunës, unë mendoj se me këtë rast nuk mundemi me bërë asgjë. Përderisa është duke u punuar një plan zhvillimor dhe nuk dihet qysh është paraparë sipas PZHK aty, kur dihet se është arteria kryesore e qytetit. Ne e dimë se të NASA kemi ngushtim të rrugës. Tani edhe në këtë pjesë po bëhet ngushtimi i rrugës. A jeni duke u bazuar në PZHK se çka jemi duke bërë. Nuk jam kundër mos me iu ndihmuar qytetarëve, mirëpo gabimet e pushtetit aktual që i ka bërë për dy dekada pa i përfillur rregullat dhe procedurat, ne nuk mundemi me ua rregulluar. I keni numrat, vazhdoni rregulloni.

**z. Korab Krasniqi:** P jap sqarime shitesë. Objekti për të cilin po flisni nuk ka pasur leje ndërtimi. Ai është ndërtim i hershëm dhe me ligjin për legalizim të objekteve, ai objekt i plotëson kushtet në të ardhmen me aplikuar. Ky është synimi i tij po besoj, por leje ndërtimi nuk ka. Nuk mundemi me thënë se iu ka dhënë leja. Tjetra, nuk ka ngushtim të rrugës aty. Ajo është në pjesën e trotuarit, kjo është gjendja ekzistuese që po thoni që 20 vjet, nuk ka kurrfarë ngushtimi të rrugës në atë pjesë. Në bazë të gjendjes aktuale, konsideroj se me mirë është me vazhduar me procedurën e këmbimit, sesa me lënë me lënë problem të pazgjidhur.

**z. Kjani Zeneli:** Mendimin tim e kam dhënë edhe në KPF, jam në ngjarje për këtë çështje. I parashoh disa gjëra në të ardhmen që nuk do ti shkojnë mirë kësaj pune, kështu që unë do të abstenoj në këtë pikë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Mendoj se është një organ me i lartë sesa KK që e vërteton ligjshmërinë e këtij vendimi. Kjo nuk na amnistion, por të paktën na lenë me kuptuar që është dikush që na mbikëqyrë neve.

**z. Korab Krasniqi:** Të plotësoj pak mendimin e Arditës. Pikërisht sot nuk e bëjmë këmbimin. Ne sot po e shpallim pronën me interes, pjesën e rrugës, me pas është procedura e vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL. Pastaj, merret vendimi tjetër për këmbimin e pronës. Kjo është procedurë që zgjatë bukur shumë deri me realizimin e saj.

**Kryesuesi i Kuvendi:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 11 votë Për, Kundër votë 5- LVV. Abstenim 2-VZHK. Prezentë 18. Konstatohet se Kuvendi i Komunës mori

#### **VENDIM**

**Për Shpallje me interes publik të Parcelës Kadastrale 00141-15 në ZK Kaçanik në pronësi private të personave fizik/ Lënda: 01Nr. 104/02-11847/26.**

Mbledhja i përfundoj në ora 13:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 18 anëtarë. Në dy pikat e fundit nuk ishte anëtari Heset Malsiu.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit  
Selajdin Troni




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/ Municipality of Kačanik

Zyra e Kryetarit

KAÇANIKU



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Data	17.06.26	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	07		400/1-19549

REFERENCË	
DATË	17.06.2026
PËR/ZA/TO:	Selajdin Troni- Kryesues i Kuvendit Komunal Zyra e Kuvendit Komunal Kačanik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Valdrin Dogani - Drejtor për Buxhet dhe Financa Gafurr Loku - Zyrtar Kryesor Financiar Komuna e Kaçanikut
NGA/OD/FROM:	Sabedin Vishi - Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përcjellja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029 për shqyrtim dhe aprovim



*I nderuar,*

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave, ju përcjellim Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale të Komunës së Kaçanikut për periudhën 2027-2029.

Dokumenti është hartuar bazuar në kufijtë fillestarë të financimit, prioritetet strategjike dhe zhvillimore të Komunës, propozimet e drejtorive komunale, si dhe rezultatet e procesit të konsultimit publik.

Bashkangjitur shkresës:

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029.

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO

**KORNIZA**  
**AFATMESME**  
**BUXHETORE (KABK) E**  
**KOMUNËS SË KAÇANIKUT**  
**2027 - 2029**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qershor 2026

**DRAFT PËR SHQYRTIM DHE APROVIM**

## STATUSI I DOKUMENTIT

Elementi	Përshkrimi
<b>Titulli</b>	Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut 2027-2029
<b>Organizata buxhetore</b>	652 Komuna e Kaçanikut
<b>Njësia përgjegjëse</b>	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
<b>Periudha e planifikimit</b>	2027-2029
<b>Baza kryesore</b>	Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut 2026-2028; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2027-2029; Qarkorja Buxhetore 2027/01; dokumentet strategjike komunale
<b>Statusi</b>	Draft për shqyrtim, konsultim publik dhe aprovim në Kuvendin Komunal

### Shënim për finalizim

Tabelat përfundimtare të ndarjeve sipas programeve dhe kategorive ekonomike harmonizohen me Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit, ndërsa projektet kapitale shumëvjeçare me sistemin Programi i Investimeve Publike, para dorëzimit zyrtar në Ministrinë e Financave.

# PËRMBAJTJA

## I. Hyrje

1.1. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029

## II. Baza ligjore, metodologjia dhe procesi buxhetor

2.1. Baza ligjore dhe dokumentet tjera relevante

2.2. Metodologjia e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

2.3. Kalendari kohor i procesit buxhetor komunal

## III. Deklarata e Komunës për prioritetet strategjike zhvillimore

3.1. Përshkrimi i komunës dhe profili socio-ekonomik

3.2. Struktura organizative e Komunës

3.3. Vizioni dhe misioni i Komunës

3.4. Prioritetet dhe objektivat afatmesme 2027-2029

## IV. Korniza Fiskale Komunale

4.1. Burimet e financimit komunal për vitet 2027-2029

4.2. Orientimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore

4.3. Investimet kapitale dhe planifikimi shumëvjeçar

## I. HYRJE

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2027–2029 dhe Qarkoren Buxhetore 2027/01, Komuna e Kaçanikut ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për periudhën 2027–2029.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale është dokumenti kryesor i planifikimit buxhetor, i cili lidh prioritetet strategjike dhe zhvillimore të komunës me kapacitetet reale financiare. Ajo paraqet burimet e pritshme të financimit, kufijtë fillestarë buxhetorë, orientimin e shpenzimeve sipas programeve dhe kategorive ekonomike, si dhe investimet kapitale për periudhën trevjeçare. Dokumenti shërben si bazë për hartimin e propozim-buxhetit të vitit 2027 dhe vlerësimeve për vitet 2028 dhe 2029.

Në hartimin e dokumentit janë marrë për bazë Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026–2028, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Kaçanikut 2026–2030, të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024, propozimet e drejtorive komunale dhe kufijtë fillestarë të financimit të përcaktuar nga Ministria e Financave, përmes Qarkores Buxhetore 2027/01.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Qarkorja Buxhetore përcaktojnë parametrat makro-fiskalë, kufijtë e financimit dhe kalendarin e procesit buxhetor. Në përputhje me këto udhëzime, drejtoritë komunale obligohen që kërkesat buxhetore t'i paraqesin brenda kufijve të përcaktuar, t'i arsyetojnë projektet e reja dhe t'u japin përparësi obligimeve ekzistuese, shërbimeve esenciale, projekteve në vazhdim dhe investimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve.

### Qëllimi i dokumentit

Qëllimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale është të sigurojë një bazë të qartë, të qëndrueshme dhe të matshme për planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare të komunës, duke ndërlidhur prioritetet strategjike me programet buxhetore dhe mundësitë reale të financimit.

### 1.1. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029

- Të paraqesë burimet e pritshme të financimit dhe kufijtë fiskalë për periudhën 2027–2029;
- Të lidhë prioritetet strategjike të komunës me programet buxhetore dhe projektet kapitale;
- Të përmirësojë planifikimin shumëvjeçar, realizimin e buxhetit dhe matjen e rezultateve;
- Të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe përmbushjen e obligimeve kontraktuale dhe ligjore;
- T'u japë përparësi projekteve në vazhdim dhe investimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve;
- Të forcojë transparencën, pjesëmarrjen qytetare, barazinë gjinore dhe llogaridhënien buxhetore.



Figura 1. Kaçaniku

## II. BAZA LIGJORE, METODOLOGJIA DHE PROCESI BUXHETOR

### 2.1. Baza ligjore dhe dokumentet tjera relevante

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale mbështetet në legjislacionin dhe dokumentet kryesore të planifikimit financiar e strategjik, përfshirë:

- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;
- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2027-2029;
- Qarkoren Buxhetore 2027/01 të Ministrisë së Financave;
- Statutin e Komunës së Kaçanikut;
- Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Kaçanikut 2026-2030;
- Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024, si dhe të dhënat buxhetore dhe financiare të Komunës.

### 2.2. Metodologjia e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029 është hartuar përmes analizës së të dhënave buxhetore, harmonizimit me prioritetet komunale dhe konsultimit me drejtorinë dhe publikun.

Hapi	Përmbajtja
<b>Analiza e bazës</b>	Shqyrtimi i KABK-së 2026-2028, Buxhetit të aprovuar 2026, obligimeve dhe realizimit aktual.
<b>Përditësimi i të dhënave</b>	Përdorimi i të dhënave të regjistrimit 2024, informatave sektoriale dhe strukturës aktuale programore.
<b>Harmonizimi strategjik</b>	Lidhja e prioritetëve me Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2030 dhe dokumentet tjera komunale.
<b>Kufijtë financiarë</b>	Zbatimi i kufijve fillestarë të Qarkores Buxhetore 2027/01 për grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake.
<b>Planifikimi shumëvjeçar</b>	Planifikimi i projekteve kapitale sipas viteve
<b>Konsultimi</b>	Shqyrtimi me drejtorinë, publikimi i draftit, dëgjimet publike dhe përfshirja e komenteve të arsyeshme.

### 2.3. Kalendari kohor i procesit buxhetor komunal

Procesi buxhetor komunal zhvillohet sipas afateve dhe aktiviteteve të përcaktuara në kalendarin vijues.

Afati	Aktiviteti
<b>30 qershor 2026</b>	Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029.
<b>qershor - korrik 2026</b>	Përcaktimi i kufijve të brendshëm për programet dhe dorëzimi i kërkesave nga drejtorinë.
<b>korrik - gusht 2026</b>	Analiza e kërkesave, dëgjimet buxhetore dhe harmonizimi në Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit dhe në Programin e Investimeve Publike.
<b>01 shtator 2026</b>	Dorëzimi i propozim-buxhetit nga Kryetari në Kuvendin Komunal.
<b>30 shtator 2026</b>	Aprovimi i propozim-buxhetit 2027-2029 nga Kuvendi Komunal dhe dorëzimi në MF.

#### Kriteri i prioritizimit buxhetor

Kërkesat për politika ose projekte të reja trajtohen vetëm pasi të jenë siguruar obligimet ekzistuese, projektet në vazhdim, shpenzimet esenciale (rrjedhëse) dhe detyrimet që mund të rrjedhin nga vendimet gjyqësore ose përmbarimore.

## III. DEKLARATA E KOMUNËS PËR PRIORITETET STRATEGJIKE ZHVILLIMORE

### 3.1. Përshkrimi i komunës dhe profili socio-ekonomik

Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës, në një sipërfaqe prej rreth 211.13 km<sup>2</sup>. Ajo përbëhet nga 31 vendbanime, prej të cilave një është urban dhe 30 janë rurale. Kaçaniku kufizohet me Ferizajn, Vitinë, Shtërpçën, Hanin e Elezit dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pozita përgjatë Autoudhës R6, rrugës nacionale N2 dhe linjës hekurudhore Fushë Kosovë–Shkup i jep Kaçanikut rëndësi të veçantë për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave, tregtinë, turizmin dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

Territori i Komunës së Kaçanikut karakterizohet nga reliev i larmishëm, që përfshin luginën e Lepencit dhe pjesë të maleve të Sharrit dhe Karadikut. Lartësia mbidetare shtrihet nga rreth 396 metra në luginën e Lepencit deri në 2,498 metra në Majën e Lubotenit, ndërsa territori përshkohet nga lumenjtë Lepenc dhe Nerodime. Këto veçori natyrore, së bashku me Grykën e Kaçanikut, Lubotenin dhe trashëgiminë kulturore e historike, krijojnë potencial për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit malor, rural, kulturor dhe rekreativ.



Figura 2. Pozita gjeografike e Komunës së Kaçanikut në Republikën e Kosovës.

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024, Komuna e Kaçanikut ka 27,716 banorë rezidentë, krahasuar me 33,409 banorë në vitin 2011. Struktura e popullsisë është relativisht e re, me rreth 41% të banorëve nën moshën 24 vjeç. Rënia demografike, emigrimi dhe shpërndarja e popullsisë në një numër të madh vendbanimesh rurale ndikojnë në planifikimin, organizimin dhe koston e shërbimeve publike, veçanërisht në arsim, shëndetësi, transport dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike.

Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në tregti, ndërtimtari, transport, gastronomi, shërbime dhe ndërmarrje të vogla. Deri në janar 2026, në Komunën e Kaçanikut ishin të regjistruara 1,696 ndërmarrje.

Sfidat kryesore mbeten emigrimi, kapacitetet e kufizuara prodhuese, nevoja për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi i qëndrueshëm me ujë, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit, mbrojtja e mjedisit dhe rritja e të hyrave vetanake.

Këto sfida janë reflektuar në prioritetet afatmesme dhe në orientimin e shpenzimeve për periudhën 2027–2029.

### 3.2. Struktura organizative e Komunës

Organet e Komunës së Kaçanikut janë:

1. Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë legjislativ i Komunës dhe
2. Kryetari i Komunës, si organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi i Komunës ushtron funksionin legjislativ, miraton aktet komunale, buxhetin dhe dokumentet strategjike, si dhe mbikëqyr zbatimin e politikave komunale.

Kuvendi Komunal përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët përfaqësojnë pesë (5) subjekte politike.

Nga gjithsej 21 anëtarë, tetë (8) prej tyre janë femra.

Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe është përgjegjës për udhëheqjen e ekzekutivit, zbatimin e vendimeve të Kuvendit Komunal dhe administrimin e përgjithshëm të Komunës. Në ushtrimin e detyrave të tij, Kryetari mbështetet nga stafi i tij, Nënkryetari dhe drejtoritë komunale.

Administrata komunale është e organizuar në këto drejtori:

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
4. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
5. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit;
6. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
7. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
8. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
9. Drejtoria e Arsimit.

### 3.3. Vizioni dhe misioni i Komunës

Vizioni dhe misioni i Komunës së Kaçanikut përcaktojnë orientimin afatgjatë të zhvillimit dhe shërbejnë si bazë për hartimin e politikave, programeve dhe prioritetëve buxhetore. Ato pasqyrojnë synimin e Komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, përmirësim të mirëqenies së qytetarëve dhe shfrytëzim të përgjegjshëm të potencialeve natyrore, njerëzore dhe kulturore.

#### Vizioni

“Kaçaniku me mundësi për të gjithë, i zhvilluar nga burime të shëndosha natyrore dhe krenar me trashëgiminë e tij”

#### Misioni

“Komuna e Kaçanikut është e përkushtuar të zhvillojë një ekonomi lokale të fuqishme dhe të qëndrueshme, duke mbështetur bujqësinë moderne, industrinë inovatore dhe turizmin atraktiv si shtylla kyçe të progresit. Me fokus të veçantë në ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm, komuna synon të krijojë një komunitet të shëndetshëm dhe dinamik, të përbërë nga qytetarë të arsimuar dhe me rini aktive në kulturë, sport dhe shoqëri.”

Realizimi i vizionit dhe misionit të Komunës mbështetet në zhvillimin ekonomik dhe inovacionin, qëndrueshmërinë mjedisore, transparencën dhe integritetin, pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, arsimin cilësor dhe fuqizimin e komunitetit, si dhe mirëqenien sociale dhe barazinë. Këto vlera udhëheqin hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe prioritetëve buxhetore të Komunës.

### 3.4. Prioritetet dhe objektivat afatmesme 2027-2029

Prioritetet janë organizuar në pesë fusha strategjike, të harmonizuara me dokumentet zhvillimore komunale dhe me strukturën e programeve buxhetore.

#### PRIORITETI 1 – Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm lokal

Ky prioritet synon krijimin e kushteve të favorshme për investime, zhvillimin e bizneseve, inovacionin dhe punësimin, duke shfrytëzuar potencialet lokale dhe pozitën gjeografike të komunës. Prioritet i kushtohet funksionalizimit të zonave ekonomike, mbështetjes së bizneseve, digjitalizimit, zhvillimit të turizmit dhe bashkëpunimit me sektorin privat.

Objektivi	Veprimet kryesore	Matësi / Caku	Përgjegjës
<b>1.1. Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe industriale</b>	Përfundimi i infrastrukturës; krijimi i modelit të menaxhimit; promovimi digjital; organizimi i panairit ekonomik; mbështetja e investitorëve.	Numri i zonave të funksionalizuara; modeli i menaxhimit i zbatuar; platforma funksionale; numri i investitorëve dhe bizneseve të vendosura.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
<b>1.2. Lehtësimi i procedurave për themelimin dhe zhvillimin e bizneseve</b>	Subvencionimi i bizneseve; promovimi digjital; thjeshtimi i regjistrimit; fushata për ndërmarrësi; këshillimi dhe mbështetja profesionale për bizneset.	Numri i bizneseve të mbështetura; koha e regjistrimit; numri i fushatave dhe përfituesve.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit; Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
<b>1.3. Zhvillimi i kapaciteteve lokale për inovacion dhe digjitalizim</b>	Krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Teknologji; trajnime digjitale; mbështetje për startup-et; gara dhe ngjarje inovative.	Qendra e funksionalizuar; numri i trajnimeve, pjesëmarrësve dhe startup-eve të mbështetura.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit; Drejtoria e Administratës së Përgjithshme / Njësia e Teknologjisë Informativë.
<b>1.4. Zhvillimi i turizmit lokal si komponent ekonomik</b>	Hartimi i dokumentit për turizëm; vendosja e sinjalistikës; promovimi i vendeve turistike përmes një platforme digjitale; organizimi i festivaleve; përmirësimi i infrastrukturës turistike.	Numri i pikave dhe shenjave turistike; numri i ngjarjeve; rritja e vizitorëve; projektet turistike të realizuara.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit; Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
<b>1.5. Zbatimi i politikave për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm</b>	Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë; konsultimi me bizneset; trajnimi i stafit; ndërtimi i kioskave; projekte turistike; panairi i punës për të rinj dhe gra.	Numri i masave të zbatuara; partneritetet me sektorin privat; numri i kioskave, projekteve dhe përfituesve.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Kaçaniku ka përparësi të rëndësishme për zhvillim ekonomik, falë pozitës së favorshme gjeografike, lidhjeve rrugore dhe hekurudhore, afërsisë me pikat kufitare dhe resurseve natyrore për industrinë e ndërtimit, drurit dhe ujit. Komuna synon të krijojë kushte më të mira për bizneset vendore dhe investitorët, përmes lehtësimit të procedurave, ofrimit të informatave dhe këshillimit për biznese, si dhe vënies në shfrytëzim të pronave komunale për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Turizmi paraqet një potencial të rëndësishëm zhvillimor, veçanërisht turizmi malor, rural dhe rekreativ. Gryka e Kaçanikut, Luboteni, trashëgimia kulturore dhe fshati turistik Strazhë, i shpallur peizazh i mbrojtur dhe i rrethuar me sipërfaqe të mëdha pyjore, krijojnë mundësi për rritjen e vizitueshmërisë dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

Komuna do të vazhdojë të mbështesë projektet për përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e resurseve natyrore e kulturore.



Figura 3. Parku rekreativ në fshatin Shtrazë

## PRIORITETI 2 – Përmirësimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi urban

Ky prioritet synon modernizimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e shërbimeve bazë dhe krijimin e hapësirave publike funksionale. Vëmendje e veçantë i kushtohet rrugëve, trotuareve, ujësjellësit, ndriçimit publik, kanalizimit, kolektorëve dhe gjelbërimit urban.

Objektivi	Veprimet kryesore	Matësi / Caku	Përgjegjës
<b>2.1. Ndërtimi, asfaltimi, riparimi dhe pastrimi i rrugëve</b>	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane e rurale; ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve; ndërtimi i mureve mbrojtëse; zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugëve; sinjalistika dhe siguria rrugore.	Kilometrat e rrugëve të ndërtuara ose rehabilituara; numri i trotuareve, mureve mbrojtëse dhe elementeve të sinjalistikës.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
<b>2.2. Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë</b>	Evidentimi i gjendjes së rrjetit; ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit; zgjerimi i ujësjellësit; fushata për përdorim racional.	Gjatësia e rrjetit të ndërtuar ose rehabilituar; numri i vendbanimeve të përfshira; përmirësimi i furnizimit me ujë.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës; KRU “Bifurkacioni”.
<b>2.3. Ndërtimi dhe modernizimi i ndriçimit publik</b>	Evidentimi i zonave pa ndriçim; vendosja dhe mirëmbajtja e ndriçimit; ndriçimi i parqeve; përdorimi i teknologjisë LED dhe energjisë solare.	Numri i rrugëve dhe hapësirave të ndriçuara; numri i pajisjeve të zëvendësuara; ulja e konsumit të energjisë.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
<b>2.4. Ndërtimi i kolektorëve dhe kanalizimeve</b>	Ndërtimi i kolektorëve përgjatë lumenjve; ndërtimi dhe rehabilitimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike.	Gjatësia e kolektorëve dhe kanalizimeve; numri i vendbanimeve të lidhura; reduktimi i shkarkimeve të pakontrolluara.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, KRU “Bifurkacioni”.
<b>2.5. Zhvillimi i hapësirave publike dhe gjelbërimit urban</b>	Ndërtimi dhe rehabilitimi i parqeve e shesheve; krijimi i zonave të gjelbra; ndërtimi i urave; instalimi i sistemeve të ujitjes.	Sipërfaqja e hapësirave të rehabilituara; numri i pemëve dhe bimëve dekorative; numri i urave; sipërfaqja e mbuluar me ujë.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

**PRIORITETI 3 – Zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit**

Ky prioritet synon mbështetjen e zhvillimit rural dhe ruajtjen e pasurive natyrore. Vëmendje e veçantë i kushtohet bujqësisë, mbrojtjes së tokës dhe burimeve ujore, biodiversitetit, menaxhimit të mbeturinave, pastërtisë publike dhe ndërgjegjësimit mjedisor.

Objektivi	Veprimet kryesore	Matësi / Caku	Përgjegjës
<b>3.1. Mbështetja e bujqësisë dhe zhvillimi rural</b>	Subvencionimi i fermerëve; trajnime; mbështetja e bujqësisë organike; krijimi i pikave grumbulluese.	Numri i fermerëve të mbështetur; numri i produkteve, rritja e prodhimit dhe e të ardhurave të fermerëve.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
<b>3.2. Mbrojtja e burimeve ujore dhe tokës bujqësore</b>	Fushata për përdorimin racional të ujit; ndërtimi i rezervuarëve të vegjël dhe sistemeve të ujitjes.	Numri i rezervuarëve; sipërfaqja e tokës së mbuluar me ujitje; numri i fermerëve përfitues.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.
<b>3.3. Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit</b>	Rregullimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve dhe përrockave; masa kundër erozionit.	Gjatësia e shtretërve të rregulluar ose pastruar; numri i zonave të mbrojtura; zvogëlimi i rrezikut nga erozioni dhe vërshimet.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
<b>3.4. Menaxhimi i mbeturinave dhe pastërtia publike</b>	Evidentimi i zonave pa shërbim; zgjerimi i grumbullimit; rritja e mbulueshmërisë; krijimi i qendrës së riciklimit.	Përqindja e ekonomive familjare të mbuluara; numri i vendbanimeve të përfshira; sasia e mbeturinave të ricikluara.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, KRM "Pastërtia".
<b>3.5. Edukimi mjedisor dhe ndërgjegjësimi publik</b>	Fushata për ndarjen dhe reduktimin e mbeturinave; aksione ekologjike; përfshirja e shkollave dhe grupeve rinore.	Numri i fushatave, aksioneve dhe grupeve të angazhuara; numri i pjesëmarrësve.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Drejtoria e Arsimit; Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KRM "Pastërtia".

Komuna e Kaçanikut ka potencial të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë dhe pylltarisë. Sipërfaqja e tokës bujqësore është rreth 7,643 hektarë, prej të cilave rreth 3,087 hektarë janë tokë lavërtare, 2,008 hektarë livadhe dhe 2,368 hektarë kullosa. Aktualisht kultivohen kryesisht gruri, misri, patatja, perimet dhe kulturat pemëtare, ndërsa ekziston hapësirë për shfrytëzim më të madh të tokës dhe orientimin e fermave drejt prodhimit gjysmëkomercial dhe komercial.

Burimet ujore nga Malet e Sharrit, lumenjtë Lepenc dhe Nerodime, si dhe përrrenjtë, paraqesin bazë të rëndësishme për zhvillimin e sistemeve të ujitjes. Në vitet e fundit janë realizuar investime në ndërtimin dhe rregullimin e kanaleve të ujitjes në Soponicë, Doganaj, Nikaj, Dubravë, Vatë dhe Kovaçec, ndërsa mirëmbajtja e tyre mbetet prioritet edhe për periudhën afatmesme.

Komuna ka vazhduar mbështetjen e fermerëve përmes subvencioneve, pajisjeve dhe mekanizmit bujqësor, serrave, bletarisë, pemëtarisë dhe blegtorisë, duke e plotësuar këtë përkrahje edhe me mjete të siguruara nga partnerët dhe organizatat donatore.

Sipërfaqja pyjore e komunës është rreth 12,449 hektarë, ose afërsisht 59% e territorit. Pyjet kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës, cilësinë e ajrit dhe zhvillimin rural. Prioritet mbetet mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, rikuperimi i zonave të dëmtuara dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore.

Për periudhën 2027–2029, politikat komunale do të orientohen në vazhdimin e subvencionimit të fermerëve, përmirësimin e mekanizmit, zgjerimin e serrave dhe plantacioneve, hapjen e rrugëve fushore, mbështetjen e blegtorisë dhe bletarisë, zhvillimin e sistemeve të ujitjes dhe krijimin e kushteve më të mira për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Njëkohësisht, rëndësi do t'i kushtohet mbrojtjes së tokës bujqësore, burimeve ujore dhe pyjeve, menaxhimit të mbeturinave, pastrimit të lumenjve dhe përrockave, si dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

## PRIORITETI 4 – Fuqizimi i komuniteteve përmes shëndetit, arsimit dhe përfshirjes sociale

Ky prioritet synon përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore shëndetësore dhe arsimore, si dhe forcimit të përfshirjes sociale. Vëmendje e veçantë i kushtohet shëndetit publik, mirëqenies sociale, mbështetjes së grupeve në nevojë, zhvillimit të rinisë, barazisë së mundësive dhe krijimit të komuniteteve aktive e gjithëpërfshirëse.

Objektivi	Veprimet kryesore	Matësi / Caku	Përgjegjës
<b>4.1. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe qasjes në kujdesin parësor</b>	Sigurimi i stafit dhe pajisjeve; renovimi i QMF-ve; ndërtimi i depos dhe garazhës; mirëmbajtja e QKMF-së.	Numri i stafit të angazhuar; pajisjet e blera; objektet e renovuara dhe intervenimet e mirëmbajtjes.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; QKMF.
<b>4.2. Zgjerimi i përfshirjes sociale dhe mbështetja për familjet në nevojë</b>	Regjistrimi i familjeve; ndihma materiale e financiare; banimi social; masa për vetëqëndrueshmëri; ndërtimi i QPS-së.	Numri i familjeve të regjistruara dhe të mbështetura; numri i familjeve të strehuara; QPS-ja e funksionalizuar.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Qendra për Punë Sociale.
<b>4.3. Rritja e cilësisë në arsim dhe digjitalizimi i shkollave</b>	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve; digjitalizimi; panelet solare; trajnimi i mësimitdhënësve; psikologët, pedagogët dhe asistentët; pajisja me inventar, bursat, mësimi dual.	Numri i shkollave të renovuara ose digjitalizuara; numri i mësimitdhënësve të trajnuar; shkollat me staf profesional dhe sisteme solare, numri i bursave, numri i nxënësve në mësim dual.	Drejtoria e Arsimit.
<b>4.4. Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore</b>	Rregullimi i hapësirave përkujtimore; renovimi i objekteve kulturore; subvencionimi i shoqërive kulturore e grupeve rinore; digjitalizimi i arkivës kulturo-historike.	Numri i objekteve të rregulluara; aktivitetet dhe organizatat e mbështetura; materialet e digjitalizuara.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
<b>4.5. Zhvillimi i sportit dhe aktiviteteve rekreative</b>	Ndërtimi dhe renovimi i fushave e palestrave; subvencionimi i klubeve; krijimi i Qendrës Rinore; vazhdimi i punimeve në stadium.	Numri i objekteve sportive të ndërtuara ose rinovuara; numri i klubeve të mbështetura; numri i të rinjve pjesëmarrës.	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Objektivat e sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale janë përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve, si dhe ofrimi i asistencës sociale për familjet në nevojë.

Shërbimet shëndetësore në Komunën e Kaçanikut ofrohen në nivelin parësor përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), gjashtë (6) Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe gjashtë (6) Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF). QKMF-ja, e ndërtuar në vitin 2016, ofron shërbime 24 orë në ditë, duke përfshirë mjekësinë familjare, pediatriinë, analizat laboratorike, rentgenin, stomatologjinë dhe shërbimin e mamografisë.

Me qëllim të rritjes së cilësisë dhe qasjes në shërbime specialiste, Komuna ka angazhuar përmes shërbimeve kontraktuale specialistë të pulmologjisë, gjinekologjisë, radiologjisë, mjekësisë interne dhe endokrinologjisë.

Pavarësisht përmirësimeve në infrastrukturë dhe pajisje, sektori vazhdon të përballet me sfida që lidhen me mungesën e stafit profesional shëndetësor, veçanërisht në zonat rurale. Prandaj, mbetet prioritet forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe furnizimi i qëndrueshëm me barna për qytetarët.

Në fushën e mirëqenies sociale vërehet ulje e numrit të përfituesve të ndihmës sociale, si rezultat i masave për nxitjen e investimeve, zhvillimin ekonomik, bujqësinë dhe turizmin, të cilat ndikojnë në rritjen e mundësive për punësim.

Po ashtu, Komuna ka lëshuar në përdorim objektin për banim social për përfituesit e përzgjedhur sipas thirrjes publike, duke përmirësuar kushtet e jetesës për familjet në nevojë.

Në arsim, prioritetet e përgjithshme për komunën janë: vazhdimi i ndërtimit dhe zgjerimit të infrastrukturës arsimore sipas nevojave të shkollave dhe institucioneve parashkollore, pajisja e shkollave me teknologji bashkëkohore, tabela interaktive, laboratorë dhe pajisje IT, rritja e efikasitetit energjetik në objektet shkollore, mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe avancimi i arsimit gjithëpërfshirës, forcimi i sigurisë në shkolla, fuqizimi i shërbimeve profesionale përmes angazhimit të psikologëve, pedagogëve dhe asistentëve,

mbështetja e nxënësve dhe studentëve të dalluar, zgjerimi i përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe edukimin e hershëm, si dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësimdhënësve.

Procesi arsimor në Komunën e Kaçanikut është i organizuar në katër nivele: edukimi parashkollor, arsimit fillor, arsimit i mesëm i ulët dhe arsimit i mesëm i lartë. Në komunë funksionojnë 11 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 2 shkolla të mesme të larta dhe një institucion parashkollor publik.

Në kuadër të investimeve në infrastrukturën arsimore, nga shtatori 2026 pritet të funksionalizohen çerdhja e re në Rekë dhe objekti i ri i ShFMU “Ali Asllani” në Doganaj, duke përmirësuar kushtet për edukim dhe mësimdhënie. Ndërkohë, prioritet për periudhën e ardhshme mbetet ndërtimi i objektit të ri të ShFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, me qëllim të krijimit të kushteve bashkëkohore infrastrukturore dhe mësimore për nxënësit dhe stafin arsimor. Edhe pse projekti është përfshirë në planifikimet buxhetore të nivelit qendror, përkatësisht të Ministrisë së Arsimit, deri më tani nuk ka filluar ndërtimi i tij.

Të gjitha institucionet arsimore kanë qasje në internet dhe disponojnë kabinete të teknologjisë informative.

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, prioritet mbetet zhvillimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, si dhe krijimi i hapësirave më të mira për rekreacion dhe sport. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të infrastrukturës sportive, mbështetjes së klubeve sportive dhe organizatave rinore, si dhe organizimit të aktiviteteve që nxisin pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën kulturore dhe sportive të komunës.

Infrastruktura sportive në Komunën e Kaçanikut është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, megjithatë, mbetet nevoja për zgjerimin e kapaciteteve sportive dhe rekreative. Komuna e Kaçanikut posedon një rrjet të infrastrukturës sportive që përfshin Palestrën e Sporteve, sallat e edukatës fizike në shkolla, fusha sportive në lokalitete të ndryshme dhe stadiumin e qytetit “Besnik Begunca” në Stagovë. Prioritet në periudhën e ardhshme do të jetë avancimi i mëtejshëm i kësaj infrastrukture, veçanërisht përfundimi i stadiumit të qytetit, zgjerimi i hapësirave sportive dhe rekreative, si dhe mbështetja e vazhdueshme e klubeve sportive.

Komuna e Kaçanikut posedon gjithashtu një trashëgimi të pasur, e cila përbën një vlerë të rëndësishme historike dhe kulturore. Për këtë arsye, prioritet do të vazhdojë të jetë mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, si dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore që kontribuojnë në identitetin dhe promovimin e komunës.



Figura 4. Ndeshje futbollit në stadiumin “Besnik Begunca”

**PRIORITETI 5 – Fuqizimi i qeverisjes lokale dhe efikasitetit administrativ**

Ky prioritet synon modernizimin e administratës komunale përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike, digjitalizimit të proceseve administrative, zhvillimit të kapaciteteve profesionale të stafit dhe avancimit të infrastrukturës komunale. Vëmendje e veçantë i kushtohet transparencës, llogaridhënies, përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjes së efikasitetit në menaxhimin e burimeve publike.

Objektivi	Veprimet kryesore	Matësi / Caku	Përgjegjës
<b>5.1. Rritja e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve komunale</b>	Zbatimi i modelit “One-Stop Shop”; standardizimi i procedurave; vlerësimi i kënaqësisë së qytetarëve; harmonizimi i strategjive.	Përqindja e shërbimeve të integruara; koha mesatare e trajtimit të kërkesave; niveli i kënaqësisë së qytetarëve.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme; Qendra për Shërbim me Qytetarë.
<b>5.2. Digjitalizimi i proceseve dhe avancimi drejt një “zyre pa letra”</b>	Digjitalizimi i regjistrit civil dhe arkivës; platforma online; sistemi elektronik i menaxhimit të dokumenteve.	Numri i dokumenteve dhe shërbimeve të digjitalizuara; përqindja e proceseve elektronike; ulja e përdorimit të letrës.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme; Njësia e Teknologjisë Informative.
<b>5.3. Përmirësimi i infrastrukturës fizike të objekteve komunale</b>	Parkingu nëntokësor; aneksi i administratës; rregullimi i hapësirës së jashtme të objektit komunal dhe qasja universale.	Numri i objekteve të rehabilituara; përmirësimi i efikasitetit energjetike; objektet me qasje për persona me aftësi të kufizuara.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.
<b>5.4. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit komunal</b>	Trajnime për etikë dhe komunikim, teknologji informative dhe e-qeverisje; programi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional.	Numri dhe përqindja e stafit të trajnuar; numri i moduleve dhe trajnimeve të realizuara.	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe të gjitha drejtoritë komunale.
<b>5.5. Promovimi i transparencës, barazisë dhe përfshirjes qytetare</b>	Platforma e transparencës; forumet me qytetarët; programi për barazi gjinore; fushatat për rritjen e inkasimit të të hyrave vetanake.	Numri i dokumenteve të publikuara; numri i konsultimeve dhe pjesëmarrësve; masat për barazi gjinore; rritja e inkasimit.	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Zyra për Barazi Gjinore.

## IV. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

Korniza fiskale për periudhën 2027-2029 paraqet burimet e pritshme të financimit dhe orientimin e shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut. Viti 2026 përdoret si bazë krahasuese, ndërsa viti 2027 paraqet planifikimin fillestar dhe vitet 2028-2029 vlerësimet afatmesme sipas Qarkores Buxhetore 2027/01.

Burimet kryesore janë Granti i Përgjithshëm, Granti specifik për Arsim, Granti specifik për Shëndetësi, financimi për shërbime rezidenciale dhe të hyrat vetanake komunale. Shumat mund të pësojnë ndryshime përmes qarkoreve pasuese dhe gjatë harmonizimit përfundimtar të buxhetit.

### 4.1. Burimet e financimit komunal për vitet 2027-2029

Burimi i financimit	2026 Aktual	2027 Planifikim	2028 Vlerësim	2029 Vlerësim	Ndryshimi 2027/2026	Rritja
Granti i Përgjithshëm	5,656,269.00 €	6,339,269.00 €	6,645,700.00 €	7,163,197.00 €	683,000.00 €	12.08%
Granti specifik për Arsim	4,761,842.00 €	4,492,490.00 €	4,627,265.00 €	4,766,083.00 €	(269,352.00 €)	-5.66%
Granti specifik për Shëndetësi	1,686,509.00 €	1,795,737.00 €	1,849,609.00 €	1,905,098.00 €	109,228.00 €	6.48%
Financimi për shërbime rezidenciale	230,000.00 €	230,000.00 €	200,000.00 €	200,000.00 €	0.00 €	0.00%
Të hyrat vetanake komunale	1,065,133.00 €	1,203,387.00 €	1,241,808.00 €	1,303,689.00 €	138,254.00 €	12.98%
<b>TOTALI I BUXHETIT</b>	<b>13,399,753.00 €</b>	<b>14,060,883.00 €</b>	<b>14,564,382.00 €</b>	<b>15,338,067.00 €</b>	<b>661,130.00 €</b>	<b>4.93%</b>

#### Përmbledhje fiskale

Buxheti i planifikuar rritet nga 13,399,753.00 € në vitin 2026 në 14,060,883.00 € në vitin 2027, ose për 661,130.00 € / 4.93%. Vlerësimet arrijnë 14,564,382.00 € në vitin 2028 dhe 15,338,067.00 € në vitin 2029.

#### Struktura e burimeve të financimit

Viti	Financimi qeveritar	Pjesëmarrja	Të hyrat vetanake	Pjesëmarrja	Totali
2027	12,857,496.00 €	91.44%	1,203,387.00 €	8.56%	14,060,883.00 €
2028	13,322,574.00 €	91.47%	1,241,808.00 €	8.53%	14,564,382.00 €
2029	14,034,378.00 €	91.50%	1,303,689.00 €	8.50%	15,338,067.00 €

#### Granti i Përgjithshëm

Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë buxhetore dhe barazisë ndërmjet komunave. Për Kaçanikun është planifikuar 6,339,269.00 € në vitin 2027, 6,645,700.00 € në vitin 2028 dhe 7,163,197.00 € në vitin 2029. Rritja në vitin 2027 krahasuar me bazën e rishpërndarë të vitit 2026 është 683,000.00 €, ose 12.08%.

#### Granti specifik për Arsim

Granti specifik për Arsim parauniversitar planifikohet në 4,492,490.00 € për vitin 2027, ndërsa vlerësimet për 2028 dhe 2029 janë 4,627,265.00 € dhe 4,766,083.00 €.

#### Granti specifik për Shëndetësi

Granti specifik për Shëndetësi planifikohet në 1,795,737.00 € për vitin 2027, me rritje graduale në 1,849,609.00 € dhe 1,905,098.00 € për vitet pasuese.

#### Financimi për shërbime rezidenciale

Për shërbimet rezidenciale në Kaçanik është paraparë financim i veçantë prej 230,000.00 € në vitin 2027 dhe nga 200,000.00 € për vitet 2028 dhe 2029. Këto mjete duhet të planifikohen e zbatohen sipas destinimit, strukturës së lejuar të shpenzimeve dhe progresit të projektit/shërbimit përkatës.

#### Të hyrat vetanake komunale

Të hyrat vetanake janë komponent i rëndësishëm i autonomisë financiare të komunës. Ato përfshijnë tatimin në pronë, taksat dhe tarifat komunale, licencat e lejet, certifikatat dhe dokumentet zyrtare, qiratë, bashkëpagesat dhe të hyrat tjera sipas planit kontabël.

Viti	Të hyrat vetanake	Pjesëmarrja në buxhet	Buxheti total
2026	1,065,133.00 €	7.95%	13,399,753.00 €
2027	1,203,387.00 €	8.56%	14,060,883.00 €
2028	1,241,808.00 €	8.53%	14,564,382.00 €
2029	1,303,689.00 €	8.50%	15,338,067.00 €

Për realizimin e projeksioneve kërkohet përmirësim i evidencave, faturim i rregullt, regjistrim i pronave të reja dhe verifikim i pronave ekzistuese, përcjellje e obligimeve, lehtësim i pagesave elektronike dhe zbatim i masave të ligjshme për inkasim. Planifikimi duhet të jetë realist dhe të mbështetet në trendet e realizimit, jo vetëm në nevojat për shpenzim.

## 4.2. Orientimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike dhe programeve buxhetore

Kategoria ekonomike	Orientimi 2027-2029
<b>Paga dhe shtesa</b>	Planifikim brenda numrit të stafit dhe kufijve të lejuar; pozitat aktuale sipas bazës së prillit 2026 dhe rritjes për përvojë; pozitat e paplotësuara sipas rregullave të Qarkores.
<b>Mallra dhe shërbime</b>	Prioritet për shërbimet esenciale, mirëmbajtjen, furnizimet bazë, shërbimet profesionale, digjitalizimin, funksionimin e administratës, arsimit e shëndetësisë.
<b>Shpenzime komunale</b>	Planifikim realist për energji, ujë, mbeturina dhe telefon.
<b>Subvencione dhe transfere</b>	Mbështetje transparente dhe e orientuar në rezultate për bujqësi, biznese, kulturë, rini, sport, OJQ, transport, arsim dhe raste sociale, sipas bazës ligjore dhe thirrjeve publike.
<b>Investime kapitale</b>	Përparësi projekteve në vazhdim, obligimeve kontraktuale dhe projekteve të arsyetuara; planifikim shumëvjeçar në Programin e Investimeve Publike dhe përfshirje e kostos së plotë, përfshirë shpronësimin kur aplikohet.

### Rregull i planifikimit

Ndarjet përfundimtare sipas kategorive ekonomike dhe programeve paraqiten në Tabelën 4.1 të Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029 përcakton orientimin dhe kufijtë, ndërsa propozim-buxheti detajon alokimet operative.

Në faqet vijuese paraqiten ndarjet e planifikuara buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe nënprogrameve buxhetore, si në vijim:

Tabela 1. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës për vitin 2027;

Tabela 2. Ndryshimi i ndarjeve buxhetore 2027/2026 sipas nënprogrameve dhe kategorive ekonomike;

Tabela 3. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës për vitin 2026;

Tabela 4. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës për vitin 2028 dhe

Tabela 5. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës për vitin 2029.

**Tabela 1. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027**

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)	
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	306,882.00	40,000.00	-	140,000.00	-	486,882.00	3.46%	
2	16328 Administrata	24	222,517.68	125,000.00	40,000.00	-	295,000.00	682,517.68	4.85%	
3	16528 Çështje gjinore	1	12,824.00	2,000.00	-	-	-	14,824.00	0.11%	
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	229,174.68	15,000.00	-	-	-	244,174.68	1.74%	
5	17528 Buxheti	11	106,809.72	15,000.00	-	-	180,000.00	301,809.72	2.15%	
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	10	102,386.52	390,000.00	98,000.00	60,000.00	710,000.00	1,360,386.52	9.67%	
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	18	201,444.00	15,000.00	2,000.00	-	-	218,444.00	1.55%	
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	11,993.19	1,000.00	-	-	-	12,993.19	0.09%	
9	47028 Bujqësia	4	47,449.59	10,000.00	-	120,000.00	80,000.00	257,449.59	1.83%	
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	3	30,567.88	10,000.00	-	50,000.00	110,000.00	200,567.88	1.43%	
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	13	138,320.28	85,000.00	-	-	795,000.00	1,018,320.28	7.24%	
12	73037 Administrata (Sh)	3	34,878.12	1,000.00	-	-	-	35,878.12	0.26%	
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	123	1,358,597.31	270,000.00	35,000.00	-	205,000.00	1,868,597.31	13.29%	
14	75636 Shërbimet sociale	8	77,796.17	1,000.00	-	10,000.00	-	88,796.17	0.63%	
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	230,000.00	230,000.00	1.64%	
16	85028 Shërbimet kulturore	18	146,064.44	130,000.00	25,000.00	150,000.00	295,000.00	746,064.44	5.31%	
17	92140 Administrata (A)	7	71,296.56	2,000.00	-	25,000.00	-	98,296.56	0.70%	
18	92750 Arsini parafillor – çerdhet	27	229,294.32	70,000.00	15,000.00	-	110,000.00	424,294.32	3.02%	
19	93810 Arsini fillor	404	3,871,250.95	293,848.68	44,000.00	40,000.00	307,000.00	4,556,099.63	32.40%	
20	95010 Arsini i mesëm	100	992,184.92	82,302.00	20,000.00	100,000.00	20,000.00	1,214,486.92	8.64%	
<b>Gjithsej (€)</b>			<b>823</b>	<b>8,191,732.32</b>	<b>1,558,150.68</b>	<b>279,000.00</b>	<b>695,000.00</b>	<b>3,337,000.00</b>	<b>14,060,883.00</b>	<b>100.00%</b>
<b>Struktura sipas kategorive të shpenzimeve</b>			<b>58.26%</b>	<b>11.08%</b>	<b>1.98%</b>	<b>4.94%</b>	<b>23.73%</b>	<b>100.00%</b>		

**Tabela 2. Ndryshimi i ndarjeve buxhetore 2027/2026 sipas nënprogrameve dhe kategorive ekonomike**

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)	
1	16028 Zyra e Kryetarit	-	6,604.00	10,000.00	-	-	-	16,604.00	2.51%	
2	16328 Administrata	-	10,792.68	30,000.00	15,000.00	-	171,000.00	226,792.68	34.30%	
3	16528 Çështje gjinore	-	635.00	(3,000.00)	-	-	-	(2,365.00)	-0.36%	
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	-	8,720.68	-	-	-	-	8,720.68	1.32%	
5	17528 Buxheti	-	(7,423.28)	-	-	-	30,000.00	22,576.72	3.41%	
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	-	7,942.52	20,000.00	10,000.00	-	43,889.00	81,631.52	12.35%	
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	-	25,950.00	5,000.00	-	-	-	30,950.00	4.68%	
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	-	(196.81)	(1,000.00)	-	-	-	(1,196.81)	-0.18%	
9	47028 Bujqësia	-	2,543.59	-	-	-	-	2,543.59	0.38%	
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	-	625.88	-	-	-	5,000.00	5,625.88	0.85%	
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	-	(238.72)	5,000.00	-	-	(117,000.00)	(112,238.72)	-16.98%	
12	73037 Administrata (Sh)	-	745.12	(2,000.00)	-	-	-	(1,254.88)	-0.19%	
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	-	127,766.31	(35,678.00)	5,000.00	-	55,000.00	152,088.31	23.00%	
14	75636 Shërbimet sociale	-	3,138.17	(6,000.00)	(5,000.00)	-	(150,000.00)	(157,861.83)	-23.88%	
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	230,000.00	230,000.00	34.79%	
16	85028 Shërbimet kulturore	-	(10,417.56)	40,000.00	-	40,000.00	(5,000.00)	64,582.44	9.77%	
17	92140 Administrata (A)	-	(6,320.44)	(1,000.00)	-	-	-	(7,320.44)	-1.11%	
18	92750 Arsini parafillor – çerdhet	-	41,119.32	20,000.00	-	-	110,000.00	171,119.32	25.88%	
19	93810 Arsini fillor	-	34,564.95	(3,151.32)	17,000.00	-	(223,000.00)	(174,586.37)	-26.41%	
20	95010 Arsini i mesëm	-	61,875.92	10,000.00	12,000.00	40,843.00	(20,000.00)	104,718.92	15.84%	
<b>Gjithsej (€)</b>			<b>308,427.32</b>	<b>88,170.68</b>	<b>54,000.00</b>	<b>80,843.00</b>	<b>129,689.00</b>	<b>661,130.00</b>	<b>100.00%</b>	
<b>Struktura sipas kategorive të shpenzimeve</b>			<b>46.65%</b>	<b>13.34%</b>	<b>8.17%</b>	<b>12.23%</b>	<b>19.62%</b>	<b>100.00%</b>		

**Tabela 3. Plan i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026**

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)	
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	300,278.00	30,000.00	-	140,000.00	-	470,278.00	3.51%	
2	16328 Administrata	24	211,725.00	95,000.00	25,000.00	-	124,000.00	455,725.00	3.40%	
3	16528 Çështje gjinore	1	12,189.00	5,000.00	-	-	-	17,189.00	0.13%	
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	220,454.00	15,000.00	-	-	-	235,454.00	1.76%	
5	17528 Buxheti	11	114,233.00	15,000.00	-	-	150,000.00	279,233.00	2.08%	
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	10	94,444.00	370,000.00	88,000.00	60,000.00	666,311.00	1,278,755.00	9.54%	
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	18	175,494.00	10,000.00	2,000.00	-	-	187,494.00	1.40%	
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	12,190.00	2,000.00	-	-	-	14,190.00	0.11%	
9	47028 Bujqësia	4	44,906.00	10,000.00	-	120,000.00	80,000.00	254,906.00	1.90%	
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	3	29,942.00	10,000.00	-	50,000.00	105,000.00	194,942.00	1.45%	
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	13	138,559.00	80,000.00	-	-	912,000.00	1,130,559.00	8.44%	
12	73037 Administrata (Sh)	3	34,133.00	3,000.00	-	-	-	37,133.00	0.28%	
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	123	1,230,831.00	305,678.00	30,000.00	-	150,000.00	1,716,509.00	12.81%	
14	75636 Shërbimet sociale	8	74,658.00	7,000.00	5,000.00	10,000.00	150,000.00	246,658.00	1.84%	
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	
16	85028 Shërbimet kulturore	18	156,482.00	90,000.00	25,000.00	110,000.00	300,000.00	681,482.00	5.09%	
17	92140 Administrata (A)	7	77,617.00	3,000.00	-	25,000.00	-	105,617.00	0.79%	
18	92750 Arsini parafillor – çerdhet	27	188,175.00	50,000.00	15,000.00	-	-	253,175.00	1.89%	
19	93810 Arsini fillor	404	3,836,686.00	297,000.00	27,000.00	40,000.00	530,000.00	4,730,686.00	35.30%	
20	95010 Arsini i mesëm	100	930,309.00	72,302.00	8,000.00	59,157.00	40,000.00	1,109,768.00	8.28%	
<b>Gjithsej (€)</b>			<b>823</b>	<b>7,883,305.00</b>	<b>1,469,980.00</b>	<b>225,000.00</b>	<b>614,157.00</b>	<b>3,207,311.00</b>	<b>13,399,753.00</b>	<b>100.00%</b>
<b>Struktura sipas kategorive të shpenzimeve</b>			<b>58.83%</b>	<b>10.97%</b>	<b>1.68%</b>	<b>4.58%</b>	<b>23.94%</b>	<b>100.00%</b>		

Tabela 4. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2028

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)	
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	308,416.75	40,000.00	-	140,000.00	-	488,416.75	3.35%	
2	16328 Administrata	24	223,630.27	125,000.00	42,000.00	-	250,000.00	640,630.27	4.40%	
3	16528 Çështje gjinore	1	12,888.12	2,000.00	-	-	-	14,888.12	0.10%	
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	230,320.55	20,000.00	-	-	-	250,320.55	1.72%	
5	17528 Buxheti	11	107,343.77	15,000.00	-	-	200,000.00	322,343.77	2.21%	
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	10	102,898.45	405,000.00	103,000.00	65,000.00	918,000.00	1,593,898.45	10.94%	
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	18	202,451.22	15,000.00	2,000.00	-	-	219,451.22	1.51%	
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	12,053.16	1,000.00	-	-	-	13,053.16	0.09%	
9	47028 Bujqësia	4	47,686.84	10,000.00	-	130,000.00	80,000.00	267,686.84	1.84%	
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	3	30,720.72	10,000.00	-	55,000.00	130,000.00	225,720.72	1.55%	
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	13	139,011.88	90,000.00	-	-	970,000.00	1,199,011.88	8.23%	
12	73037 Administrata (Sh)	3	35,052.51	1,000.00	-	-	-	36,052.51	0.25%	
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	123	1,365,390.30	290,000.00	35,000.00	-	230,000.00	1,920,390.30	13.19%	
14	75636 Shërbimet sociale	8	78,185.15	5,000.00	-	10,000.00	174,000.00	267,185.15	1.83%	
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	200,000.00	200,000.00	1.37%	
16	85028 Shërbimet kulturore	18	146,794.76	140,000.00	25,000.00	160,000.00	217,540.00	689,334.76	4.73%	
17	92140 Administrata (A)	7	71,653.04	2,000.00	-	25,000.00	-	98,653.04	0.68%	
18	92750 Arsimiti parafillor – çerdhet	27	230,440.79	70,000.00	17,000.00	-	-	317,440.79	2.18%	
19	93810 Arsimiti fillor	404	3,890,607.20	293,848.68	46,000.00	40,000.00	100,000.00	4,370,455.88	30.01%	
20	95010 Arsimiti i mesëm	100	997,145.84	82,302.00	20,000.00	105,000.00	225,000.00	1,429,447.84	9.81%	
Gjithsej (€)			823	8,232,691.32	1,617,150.68	290,000.00	730,000.00	3,694,540.00	14,564,382.00	100.00%
Struktura sipas kategorive të shpenzimeve			56.53%	11.10%	1.99%	5.01%	25.37%	100.00%		

Tabela 5. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2029

Nr.	Kodi dhe emri i nënprogramit buxhetor	Stafi	Paga dhe shtesa (€)	Mallra dhe shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Pjesëmarrja në buxhet (%)	
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	309,960.37	50,000.00	-	140,000.00	-	499,960.37	3.26%	
2	16328 Administrata	24	224,748.42	125,000.00	42,000.00	-	50,000.00	441,748.42	2.88%	
3	16528 Çështje gjinore	1	12,952.56	5,000.00	-	-	-	17,952.56	0.12%	
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	231,472.16	15,000.00	-	-	-	246,472.16	1.61%	
5	17528 Buxheti	11	107,880.49	15,000.00	-	-	350,000.00	472,880.49	3.08%	
6	18028 Shërbime publike – infrastruktura rrugore	10	103,412.94	420,000.00	109,000.00	65,000.00	1,160,000.00	1,857,412.94	12.11%	
7	18432 Zjarrfikësit dhe inspektimet	18	203,463.48	15,000.00	2,000.00	-	-	220,463.48	1.44%	
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	12,113.42	1,000.00	-	-	-	13,113.42	0.09%	
9	47028 Bujqësia	4	47,925.27	10,000.00	-	140,000.00	100,000.00	297,925.27	1.94%	
10	48028 Planifikimi dhe zhvillimi ekonomik	3	30,874.32	10,000.00	-	60,000.00	150,000.00	250,874.32	1.64%	
11	66445 Planifikimi, urbanizmi dhe inspekcioni	13	139,706.94	95,000.00	-	-	1,040,000.00	1,274,706.94	8.31%	
12	73037 Administrata (Sh)	3	35,227.77	1,000.00	-	-	-	36,227.77	0.24%	
13	74700 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	123	1,372,217.25	290,000.00	35,000.00	-	210,000.00	1,907,217.25	12.43%	
14	75636 Shërbimet sociale	8	78,576.07	5,000.00	-	10,000.00	150,000.00	243,576.07	1.59%	
15	75637 Shërbimet rezidenciale	-	-	-	-	-	200,000.00	200,000.00	1.30%	
16	85028 Shërbimet kulturore	18	147,528.74	150,000.00	25,000.00	150,000.00	350,000.00	822,528.74	5.36%	
17	92140 Administrata (A)	7	72,011.31	2,000.00	-	30,000.00	-	104,011.31	0.68%	
18	92750 Arsimiti parafillor – çerdhet	27	231,593.00	70,000.00	18,000.00	-	-	319,593.00	2.08%	
19	93810 Arsimiti fillor	404	3,910,060.24	293,848.68	48,000.00	40,000.00	284,000.00	4,575,908.92	29.83%	
20	95010 Arsimiti i mesëm	100	1,002,131.57	82,362.00	21,000.00	110,000.00	320,000.00	1,535,493.57	10.01%	
Gjithsej (€)			823	8,273,856.32	1,655,210.68	300,000.00	745,000.00	4,364,000.00	15,338,067.00	100.00%
Struktura sipas kategorive të shpenzimeve			53.94%	10.79%	1.96%	4.86%	28.45%	100.00%		

### 4.3. Investimet kapitale dhe planifikimi shumëvjeçar

Investimet kapitale përbëjnë instrumentin kryesor për përmirësimin e infrastrukturës dhe zbatimin e prioritetëve zhvillimore. Kjo listë përmban 46 projekte kapitale, prej të cilave 23 janë projekte ekzistuese me kod nga Programi i Investimeve Publike dhe 23 janë projekte të reja që kërkojnë hapje ose harmonizim në sistem.

Vlera e përgjithshme e planifikimit shumëvjeçar është 11,395,540.00 €, përkatësisht 3,337,000.00 € në vitin 2027, 3,694,540.00 € në vitin 2028 dhe 4,364,000.00 € në vitin 2029.

